



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

RAPORTI I EKZEKUTIVIT PËR VITIN 2012

K a ç a n i k ; Prill 2013.

Hartoi dhe përpunoi: Zyra e Kryetarit

Vështrim Hyrës

Kam kënaqësinë të prezantoj Raportin Vjetor të punës i cili përmban punën dhe aktivitetet njëvjeçare, të arriturat e Komunës dhe njëkohësisht vështirësitë me të cilat jemi përball. Jam munduar të zbatojë aktivitetet që janë të përcaktuara me Statut të Komunës dhe zbatimin e përgjegjësive si kryetar i Komunës duke administruar pushtetin lokal në harmoni me kompetencat e kryetarit. Duke qenë përfaqësues i Komunës dhe duke vepruar në emër të saj jam munduar të shtrijë bashkëpunimin e Komunës me qytetarët, shoqërinë civile, shoqatat e ndryshme rininë etj. Një bashkëpunim të sigurtë e kam zhvilluar edhe me partitë politike e veçanërisht me opozitën duke krijuar një klimë relaksuese e bashkëpunuese, gjithnjë në interes të gjithë qytetarëve. Takimet dhe debatet me qytetarët kanë qenë të shpeshta, ndërsa janë trajtuar tema të ndryshme. Unë jam i kënaqur që kemi arritur të ndërtojmë dhe pajisim me inventar e pajisje teknologjike të avancuara Qendrën për Shërbim të Qytetarëve, në objektin e administratës dhe njëkohësisht kemi vazhduar t'i ofrojmë shërbimet sa më cilësore e të shpejta të gjithë qytetarëve. Po ashtu edhe 5 zyrat e vendit në teren janë pajisur me inventar e pajisje teknologjike ndërsa në Kaçanik të Vjetër është ndërtuar objekti i ri që ka krijuar mundësi dhe kushte më të mira për punë. Po ashtu kemi arritur që ti miratojmë edhe dy dokumente mjaft të rëndësishme: Planin Rregullues për zonën I dhe një pjesë të zonës II të Kaçanikut dhe Planin Rregullues për zonën turistike "Livadhet e Shtrazës".

Prioritetet strategjike për vitin 2012

- Planet rregulluese për zonën I urbane dhe plani rregullues për zonën turistike "Livadhet e Shtrazës";
- Ofrimi i infrastrukturës së nevojshme për të krijuar kushte për investime në zhvillimin ekonomik, në veçanti në turizëm;
- Ofrimi i shërbimeve publike dhe krijimi i infrastrukturës
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore, me theks të veçantë rrugët që lidhin vendbanimet me qendrën urbane ose rrugët lidhëse magjistrale apo regjionale.
- Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore, përmes përmbushjes së nevojave për ngritje të kapaciteteve teknike dhe njerëzore.
- Përmirësimi i shërbimeve arsimore dhe ngritja e cilësisë
- Përmirësimi i aktivitetet rinore

Prioritetet kryesore për Kaçanikun vazhdojnë të jenë:

- Përmirësimi i vazhdueshëm i mirëqenies së qytetarëve.
- Krijimi i kushteve të volitshme për investime të drejtpërdrejta, shtimi i vendeve të përhershme të punës dhe zhvillimit ekonomik.
- Ushtrimi me përgjegjësi i kompetencave në udhëheqjen e ekzekutivit të komunës, administratën e saj dhe zbatimin e akteve të Kuvendit të Komunës.
- Mbikëqyrjen e administrimit financiar të komunës dhe zbatimi i planeve investuese të komunës, përkatësisht investimet substanciale në infrastrukturë duke përfshirë rrugët, ujën e pijshëm dhe kanalizimet.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi

Aktivitetet tjera të Ekzekutivit të Komunës gjatë periudhës njëvjeçare, për vitin 2012 ishin:
Ofrimin e kushteve themelore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik
Koordinimi i aktiviteteve me donatorë dhe organizatat e brendshëm dhe të jashtëm
Përcjellja dhe menaxhimi i realizimit të projekteve
Plotësimin e nevojave të qytetarëve dhe ushtrimin e përgjegjësive nga autoritetet lokale sa më afër qytetarëve
Bashkëpunim ndër komunal
Shënimi i përvjetorëve të betejave dhe rënies së dëshmorëve, ditës së Çlirimit të Komunës, Përvjetorit të Pavarësisë, shënimi i ditëve ndërkombëtare të ndryshme etj.

► Këto shërbime ofrohen përmes drejtorive dhe zyrave në vijim:

- Zyra e Kryetarit të Komunës
- Drejtoria e Administratës së përgjithshme
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Drejtoria e Arsimit e Kulturës
- Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit
- Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike dhe
- Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë

■ Zyra e Personelit

Sipas Rregullores për procedurën e rekrutimit nga zyra e personelit janë zhvilluar të gjitha procedurat e rekrutimit për vendet e punës të shpallura publike. Kështu që gjatë këtij viti kemi përgatitur konkurse për 2 vende të lira pune. Kemi bërë përpilimin e 16 vendimeve për udhëtime zyrtare, 3 vendime mbi transferimin e punëtorëve në vend tjetër të pune dhe 16 vërtetime mbi marrëdhënien e punës.

Për ankesat e paraqitura në Këshillin e pavarur mbikëqyrës të Kosovës, kundër endimeve të komisionit komunal të ankesave kemi përgatitur përgjigjen në ankesat dhe kompletimin e fakteve dhe argumenteve për rastet konkrete. Po ashtu, janë nxjerrë vendime për pushime vjetore, pesë pushime të veçanta, 1 vendim i pushimit të lehonisë, 1 pushim pa pagesë si dhe evidentimi dhe ruajtja e tyre në mënyrë elektronike dhe në dosje personale për tërë personelin administrativ. Është bërë përpilimi i kontratave dhe akt emërimeve të reja për punëtorët komunal si dhe 8 marrëveshje për shërbime të veçanta. Mbajtja e evidencës së të gjithë punëtorëve të SHCK-ës dhe rifreskimi i tyre duke pasur parasysh të dhënat e tyre personale, gjininë, strukturën etnike, kualifikimin, titullin e pozitës, datën e fillimit, pagën etj. dhe raportimi i tyre tre mujore për administratë, arsim dhe shëndetësi në Ministrinë e Administratës Publike. Numri i përgjithshëm i shërbyesve civil komunal duke pasur parasysh edhe punëtorët e qendrës për punë sociale, zjarrfikësit dhe sektorin e pylltarisë ka arritur në 113 punëtorë pa llogaritur Zjarrfikësit që janë 18 zjarrfikës .

Janë hartuar të gjitha vendimet e marra nga Kryetari i Komunës që kanë të bëjnë me çështjet e personelit, sistematizimi i vendeve të punës dhe organogrami.

Kemi përcjellë sistemin e hyrje-daljeve të punëtorëve, vonesat dhe mungesat e tyre, duke dhënë edhe vërejtje gojore dhe me shkrim (16), Vendime për njoftimin e daljes së punëtorëve jashtë objektivit komunal është zbatuar në përpikëri.

Duke u bazuar në ligjin e festave zyrtare dhe njoftimet nga MAP-ja, kemi bërë njoftimin e personelit rreth festave zyrtare. Po ashtu , nga zyra e personelit është bërë kompletimi, ruajtja dhe mirëmbajtja e të gjitha dosjeve të personelit të SHCK-ës . Përcjellja e ftesave të trajnimeve

të stafit dhe njoftimi lidhur me to. Prezantimi në trajnime dhe takimet të organizuara nga niveli qendror.

■ Zyra për Informim

Zyra për Informim, prioritet të saj ka informimin e rregullt, të drejt dhe efikas. Zyra për Informim në vazhdimësi ka prezantua punën e të gjitha organeve të pushtetit lokal, duke promovuar transparencë në këto organe. Publiku po ashtu, përmes faqes zyrtare dhe facebookut është informuar për punën dhe aktivitetet të institucioneve tjera që i menaxhon pushteti lokal, për ngjarjet dhe zhvillimet tjera që ndodhin në komunë apo që kanë të bëjnë me komunën. Zyra për Informim, për të krijuar transparencë më të madhe dhe me qëllim të informimit, ka mbajtur kontakte të rregullta me përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik në nivel lokal dhe qendror, njoftimin e tyre për të gjitha takimet, ngjarjet, zhvillimet dhe manifestimet që mbahen në komunë.

Me qëllim të krijimit të një imazhi sa më pozitiv për komunën dhe me qëllim të publikimit të punës dhe aktivitetet të komunës si dhe me qëllim të rritjes së transparencës, është botuar Vjetari 2012. Vjetari i sivjetmë është i 5 me radhë ndërkaq Vjetari 2008 ishte numri i parë i publikuar.

Zyra për Informim ka publikua aktivitetet nga mbledhjet e Komiteteve, mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Këshillit Komunal për Siguri, Takimet e rregullta të ekzekutivit, Debatet publike me qytetarë, Dëgjimet buxhetore etj. dhe aktivitetet tjera të rëndësishme dhe me interes për publikun. Të gjitha këto aktivitete janë prezantuar në Faqen zyrtare të komunës dhe në faqen e Komunës në facebook dhe njëkohësisht duke i ofruar publikut informacione për zhvillimet në komunën tonë e më gjerë.

Zyra për Informim, po ashtu ka përcjell të gjitha takimet e kryetarit të komunës, ndërsa publiku është njoftuar rregullisht me temat dhe çështjet e trajtuara.

Zyra për Informim ka përcjell dhe publikuar të gjitha aktivitetet kulturore, sportive, përkujtimore etj si përvjetorin e shpalljes së pavarësisë, ditës së çlirimit, manifestimet përkujtimore në përvjetorin e rënies së dëshmorëve dhe betejave të zhvilluara në komunën tonë të cilat janë organizuar nën përkujdesen e kryetarit të komunës etj.

■ Zyra e Prokurimit

Zyra e Prokurimit ka udhëhequr 71 procedura të prokurimit me vlera të mesme, vlera të vogla dhe vlera minimale, dy procedura të shitjeve të asortimente drusore dhe 20 anulime.

- Kontrata me vlerë të mesme kanë qenë gjithsej 22 kontrata
- Kontratë me procedurë të kuotimit të çmimeve kanë qenë gjithsej 27 kontrata
- Kontrata me vlerë minimale gjithsej 42 kontrata
- Kontrata për shitjen e asortimenteve drusore 2 kontrata
- Anulime të procedurave të prokurimit 20.

Projektet që janë realizuar me vlerë të mesme (Kontrata me vlerë të mesme) janë:

1. Asfaltimi i rrugëve Lokale mjetet e planifikuara 50.000.00 euro, firma e kontraktuar NNT "Eurotransi"- Kaçanik
2. Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Ramadush Agushi, vlera e kontratës 49.824.45 euro, punë kryes ka qenë NNP "ATC-COM"-Kaçanik kurse vlera e paguar për punët e kryera është 43966.45 euro

3. Rregullimi i përroit te rr. Lidhja e Prizrenit vlera kontratës 24.420.00 punë kryes ka qenë NTSH"Rema" –Kaçanik kurse vlera e paguar 16.616.65 euro
 4. Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Agim Bajrami vlera e kontratës 39.815.95 euro punë kryes NNT"Magjistranja"-Gjilan vlera e pagesës është 36.024.14 euro
 5. Ndërtimi i trotuarit për këmbësor në fshatin Kaçanik i Vjetër vlera e kontratës 65.614.89 euro,vlera e pagesës 61.072.31 euro bashkëfinancues LLOGOS.
 6. Largimi i deponive ilegale dhe pastrimi i përroskave vlera e kontratës është 61,958.50 është shpërblye KRM"Pastrimi"-Prishtinë realizimi i projektit është 45,184.00 (këtë projekt e ka financuar Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale)
 7. Furnizim me derivate për nevojat e Administratës, Shëndetësinë, shkollat dhe shërbimi i zjarrfikësve fituesi NTSH"Shkëndija"-vlera e kontratës 125.000.00 euro(të planifikuara)
 8. Ndërtimi i serrave në sipërfaqe prej 256 m2 ,subvencionimin e fermerëve ,vlera e kontratës 36,700.00 euro (10 serra janë ndërtua) fituesi NSH-Kastrioti"-Ferizaj
 9. Meremetimi i pjesshëm në disa shkolla në Komunën e Kaçanikut, vlera e kontratës 27,517.12 euro fitues Shpk"Murseti Company" realizimi i këtij projekti është23,729.99 euro.
 10. Ndërtimi i murit mbrojtës në rr. Dëshmorët e Lirisë vlera e kontratës 35,711.00 euro fitues Shpk"Murseti Company" është realizua komplet projekti
 11. Furnizim me material për mirëmbajtjen e objekteve me kontratë është shpërblye NT"Jeta e Re" vlera e planifikuar e kontratës është 20.000.00 euro
 12. Punimi i varrezave të dëshmorëve me kontratë është shpërblyer NNSH"P&I"-vlera e kontratës 47,837.88 euro realizimi i kontratës 21,474.43 euro
 13. Sigurimi fizik i objekteve oferta fituese Shpk'Rojet e Nderit" vlera e kontratës është 32,661.22 euro (kontratë njëvjeçare)
 14. Ndërtimi i trotuarit Bob-Kovaçec bashkëfinancues LOGOS-i, vlera e kontratës 64,949.50 euro fitues NPSH"Përza" (projekt i pa përfunduar,vazhdon në vitin 2013)
 15. Ndërtimi dhe rregullimi i katit përdhes vlera e kontratës 19,998.20 euro NNSH"P&I dhe projekti është realizuar në tërësi.
 16. Furnizim me lëndë djegëse Thëngjill për shkollat vlera e kontratës 7,540.00 euro fitues i kontratës NTP"Ajroni Com" Prishtinë.
 17. Furnizim me lëndë djegëse Dru për Shkollat,Shëndetësinë dhe Zyret e ofiçarisë në teren vlera e kontratës 59,850.00 euro.
 18. Asfaltimi i rrugës Bunjak-Mezin –Koraq vlera e kontratës 58,368.48 euro ky projekt është në realizim sipër ,vazhdon në vitin 2013 shpërblyes i kontratës është NTSH"Rema"
 19. Mirëmbajtja dimërore e disa rrugëve në Komunën e Kaçanikut vlera e planifikuar është 21.300.00 euro, me kontratë është shpërblye NNT"Magjistranja"-Gjilan
 20. Furnizim me material hargjues vlera e parashikuar është 20.000.00 euro ,do të realizohet në dy pjesë(është në procedurë)
 21. Ndërtimi i shtëpisë rast social familjes Luzha nga fsh.Begracë vlera e kontratës është 19,966.65 euro me kontratë është shpërblye Shpk"Murseti Company" realizimi i projektit vazhdon në vitin 2013 (financimin e këtij projekti e bën Zyra e kryeministrit për çështje të komuniteteve).
 22. Furnizimi dhe montimi i kalldeve në sh.f' E.Duraku –Kaçanik dhe K.Zeka-fsh.Dubravë" vlera e kontratës është 11,570.00 euro ,shpërblyes i kontratës është Shpk.Termo Luzha.
- Kuotimet e çmimeve:

1. Furnizim me pajisje teknologjike Llaptop për këshilltarët komunal vlera e kontratës është 9,585.00 shpërblyes me kontratë NTSH"Elita-IT"
2. Rregullimi i stazëz gjelbëruese në pjesën lindore të lumit Nerodime vlera e kontratës 7,039.38 shpërblyes NNP"ATC-COM"
3. Furnizim me pajisje medicinale për QKMF-në vlera e kontratës 9,716.00 shpërblyes me kontratë NTSH"Atom Med"-Ferizaj
4. Furnizim me repomaterial bujqësor(farë misri dhe pleh artificial) vlera e kontratës 9,640.00 euro shpërblyes i kontratës NTP-Fitofarma –Ferizaj
5. Rregullimi i sistemit pikë-pikë të ujitjes në pemishte vlera e kontratës 8,767.50 euro shpërblyes NTSH"Ndriçimi"
6. Furnizim me material ushqimor dhe pije për nevojat e ShCK, Shkollat dhe Shëndetësinë vlera e planifikuar 10.000.00 euro shpërblyes me kontratë DPT"Gëzimi-Kaçanik
7. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve vlera e planifikuar 10,000.00 euro shpërblyes me kontratë NTP-Malësia-Kaçanik
8. Rregullimi i bustit të dëshmorit "Komandant Bardhi" vlera e kontratës 5,500.00 euro shpërblyes DPZ"Arte Atele" Fushë Kosovë
9. Sigurimi i automjeteve të Administratës,QKMF-së dhe Shërbimit të Zjarrfikësve vlera e kontratës 9.771.65 euro shpërblyes me kontratë Sh.A-Sigal' - Prishtinë
10. Shërbimet e zërimit vlera e planifikuar 10,000.00 euro shpërblyes me kontratë NSH"FBT"-Kaçanik
11. Adaptimi i hyrjes dhe daljes së urës mbi lumin Nerodime, vlera e kontratës 9,973.50 euro shpërblyes i kontratës NTSH-Ar-Driti"-Ferizaj
12. Punimi i planit rregullues urban për zonën e I-rë urbanistike në qytetin e Kaçanikut-faza e dytë shpërblyes me kontratë Shpk"Insi"Prishtinë vlera e kontratës është 9,950.00 euro
13. Hartimi i planeve rregulluese për zonat Turistike Malet e Sharrit vlera e kontratës është 9,600.00 euro shpërblyes me kontratë NSH"Eup engineering"-Prishtinë
14. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Sh.F."Kadri Zeka" në fsh.Vatë vlera e projektit 5,497.95 euro shpërblyes Shpk"Murseli Company"
15. Furnizim me material stomatologjik dhe laboratorik për QKMF-në vlera e planifikuar 10.000.00 euro shpërblyes NTSH "Atom Med" - Ferizaj
16. Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik vlera e planifikuar 10.000.00 euro shpërblyes me kontratë NTSH "Elektra" H.Elezit.
17. Ndërtimi i pllakës përkujtimore të Dëshmorëve në fsh.Kotlinë vlera e kontratës 2,760.80 euro shpërblyes NTSH"Rema"-Kaçanik
18. Sanimi i rrjetit të kanalizimit fekale në sh.f"E.Duraku" në Kaçanik vlera e kontratës 2,560.29 shpërblyes NNT"ATC-COM"-Kaçanik
19. Sanimi i rrjetit të kanalizimit fekale te banesa e ish Komitetit dhe në rrugën Ganimete Tërbeshi vlera e kontratës 2,313.70 euro shpërblyes me kontratë NPSH"Përzha"
20. Shërbimet e bufesë në Administratë vlera e planifikuar 10.000.00 euro shpërblyes DPH"Leoni -I"
21. Ndërtimi i dyerve dhe dritareve në katin përdhes të QKMF-së vlera e kontratës 9,974.50 euro shpërblyes me kontratë NNSH"P & I "
22. Furnizim me material higjenik vlera e planifikuar e kontratës është 10.000.00 euro shpërblyes NTP"Lati"-Kaçanik

23. Furnizimi dhe punimi i rrjetit të elektrikes, telefonisë dhe internetit në katin përdhes të administratës komunale vlera e kontratës 4,995.00 euro shpërblyes me kontratë NTSH "Ar-Driti" - Ferizaj
24. Ndërrimi i radiatorëve në Sh.M"Skënderbeu" vlera e kontratës 7,970.00 euro shpërblyes me kontratë NTSH"Ar-Driti"
25. Furnizim me tonera për administratën komunale vlera e planifikuar 10.000.00 euro shpërblyes me kontratë Bess toners –Gjilan
26. Furnizim me dyer dhe riparimi i tyre si dhe furnizimi me pajisje tjera Sh.M"Skënderbeu" vlera e kontratës 4,981.00 euro shpërblyes NTSH "Rema" - Kaçanik
27. Punimi i pllakës së 100 vjetorit të pavarësisë vlera e kontratës 3,230.00 euro shpërblyes me kontratë NSH "Blertoni –A " -Kaçanik.

SHITJA E ASORTIMENHTEVE DRUSORE

- 1-Shitja e ngastrave nr.2,3,7,10 vlera e kontratës është 56,,333.43 euro shpërblyes me kontratë NSHT"Lypeteni"-Kaçanik
- 2- Shitja e ngastrave nr.9 vlera e kontratës është 22,776.59 euro shpërblyes me kontratë NTSH"Dardani"-Kaçanik

■ Zyrës për teknologji informative

Zyra për Teknologji Informative ka filluar punët dhe aktivitetet harmonishëm me Planin Vjetor te punës për vitin 2012, konform detyrave dhe përgjegjësi të parapara për vendin e punës.

Aktivitetet e Zyrës për teknologji informative

- Zyra për Teknologji Informative si prioritet kryesor edhe ne këtë vit ka qenë e-qeverisja e cila përfshin intranetin, ueb faqja, e-arkiva, e-pasuria etj.
- Komuna jone është ne mesin e komunave me te suksesshëm për zhvillimin e këtij projekti, e-qeverisje(Strategjisë se Qeverisjes Elektronike 2009 – 2015). Duke u bazuar ne raportet e Konsulentit te TIK-ut nga MAPL, Komuna jone është vlerësuar te jete ndër ato me të suksesshmet.
- Ueb faqja është duke u pasuruar vazhdimisht me informata te reja, njoftime, raporte, vendime, etj. Ndërkaq e gjithë kjo mirëmbajtje dhe pasurim i te dhënave bëhet nga zyra IT dhe zyra Informimit.
- Intraneti është duke funksionuar mjaft mirë, për këtë janë realizuar edhe trajnime të vazhdueshme te personelit me qellim te implementimit te këtij programi e sidomos ne qendrën për shërbim të qytetare ku të gjitha lendet futen ne intranet te bashkangjitur me dokumente duke përdorur digjital senderin, ku deri më tani janë pranuar 32500 lende te cilat po shqyrtohen nga drejtorit komunale.
- E-arkiva në Komunën tonë është shembull për komunat tjera, në bashkëpunim me zyrën e arkivit në mënyrë elektronike, duke u bazuar ne raportet e MAPL-se
- E-pasuria, jemi duke i regjistruar te gjithë punëtoret ne këtë aplikacion ne mënyrë qe inventari te evidentohet për secilin zyrtare ne mënyrë elektronike.
- Projekti e-qeverisje është duke u aplikuar ne kuadër te programit te Qeverise dhe Strategjisë se Qeverisjes Elektronike 2009 – 2015.
- Gjate vitit 2012 kemi përdorë një forme te informimit, njoftimeve etj. përmes Ueb-sms, te cilën kemi kursye kohen dhe mjetet financiare.

- Ne këtë vit kemi filluar një aplikacion mjaft me rëndësi siç është arka elektronike dhe kërkesat automatike, ky softver shërben për lehtësimin e dokumenteve të qytetareve ky program është financuar nga MAPL-ja. Gjithashtu ne këtë vit kemi iniciuar një projekt mjaft të rëndësishëm për qendrën për shërbim të qytetareve (QSHQ-ja) dhe zyrat e vendit, projekti ne fjale është furnizim me teknologji informative dhe inventar ne QSHQ- ne dhe zyrat e vendit, qe kap një shumë prej 50,520.00 (bashkëfinancim, KOMUNA\USAID)
- Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të parapara për vendin e punës gjate kësaj periudhe kemi mirëmbajt: Kompjuterët ne administrate, serverët të cilat kane bazën e të dhënave, programin e gjendjes civile, menaxhimin e rrjetit qeveritare, trajnime të vazhdueshme të personelit, mirëmbajtja e programit të gjendjes civile ne teren ne zyrat e vendit në Doganaj, Dubrave, Kaçanik i Vjeter, Gllloboçicë dhe Ivajë.
- Mirëmbajtja e Kompjuterëve trajnime dhe përkrahje të vazhdueshme nëpër Shkolla, Shtëpi Kulturës, QKMF, QPS, Zjarrfikësit ndërsa është bërë edhe monitorimi i kamerave dhe mirëmbajtja e kontrollorit të punës.
- Ne kuadër të përgjegjësi të paraparë për vendin e punës kemi kryer edhe pune shtese si: Kryesues i komisionit për vlerësim të patundshmërisë dhe si Zyrtar për Anti korrupsion-regjistrimin e dhuratave ne katalogun e dhuratave.
- Zyrtare për Anti korrupsion- regjistrimin e dhuratave ne katalogun e dhuratave gjate kësaj periudhe janë dorëzuar formularët për deklarim të pasurisë dhe formulari për deklarim të dhuratave. Zyrtarët e lartë komunal kanë deklaruar pasuritë e tyre e cila është bërë publike ndërkaq në formularët e deklarimit të dhuratave nuk është regjistruar ndonjë dhuratë.

■ Zyra për Komunitete dhe Kthim

Sipas regjistrimit statistikave të zyrës së aeroportit, deri në fund të këtij viti kemi gjithsej 35 persona të riatdhesuar të komunës sonë prej të cilëve 5 janë kthyer nga Belgjika, 1 nga Norvegjia, 1 nga Holanda, 4 Austria, 5 Zvicra, 3 nga Gjermania, 4 Hungaria, 1 Amerika, 8 Franca, 2 Suedia 1 pa të dhëna.

Gjatë këtij viti kemi pasur shumë raste të paraqitura të cilat i kemi njoftuar me të drejtat e tyre për aplikim në fondin për riintegrimin e personave të riatdhesuar, iu kemi ofruar asistencë në rregullimin e dokumentacionit të gjendjes civile, për asistencë sociale, dokumenteve kadastrale, në përgatitjen e planeve të biznesit dhe i kemi udhëzuar për tu lajmëruar në entin për punësim. Po ashtu, anëtarët e komisionit për riintegrim kanë verifikuar rastet në teren dhe iu kanë ndihmuar rreth përgatitjes së paramasave dhe parallogarive rreth kërkesave për meremetim të shtëpive.

Jemi angazhuar edhe rreth vetëdijesimit të personave të riatdhesuar përmes kontakteve të drejtpërdrejta me ta dhe fletëpalosjeve të ndryshme, udhëzuesve për riintegrim dhe njoftimeve të cilat janë plasuar edhe në Eëb-faqen komunale. Me OSBE-në kemi organizuar edhe një drekë pune ku është prezantuar fletëpalosja informative me informacionin e kontaktit për të kthyerit dhe personat e riatdhesuar ne rajonin e Gjilanit.

Në fillim të muajit gusht është formuar komisioni komunal për riintegrim sipas Rregullores Nr.10/2012 për menaxhimin e programit, organet kompetente, procedurat dhe kriteret e përfitimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar.

Kemi pranuar kërkesa për ndihmë nga fondi për riatdhesim, të cilat janë shqyrtuar dhe kompletuar duke pasur parasysh kriteret e përcaktuara në Rregulloren Nr. 10/2012 për menaxhimin e programit, organet kompetente, procedurat dhe kriteret e përfitimit për

riintegrimin e personave të riatdhesuar të cilat pas shqyrtimit nga ZKK-ja , komisioni komunal për riintegrim janë përcjellur në Ministrinë e punëve të brendshme .

Gjatë këtij viti nga zyra për riintegrim e MPB-ës jemi njoftuar me këto lëndë të shqyrtuara nga Bordi për riintegrim:

Kërkesat e miratuara (8) :

- Gjashtë (6)kërkesa për pako ushqimore, prej tyre dy kërkesa për pako ushqimore te përcjellura vitin e kaluar dhe katër kërkesa të këtij viti, të cilat në çdo dy muaj kanë marrë pakot ushqimore dhe higjienike dy mujore
- Një(1) kërkesë për plan biznesi gjegjësisht pajisje dhe inventar për hapjen e nje lokali – kafeje dhe
- Një familje 4 anëtarësh iu është siguruar strehimi/banimi në Ferizaj.

Të refuzuara i kemi 6 kërkesa për të cilat është kërkuar plotësim i dokumentacionit;

- Tri (3) kërkesa për plane biznesi,
- Një (1) për riparim shtëpie,
- Një (1) për ndërtim shtëpie dhe
- Një (1) kërkesë për pako ushqimore (është kërkuar vendimi i KKR-ës)

Ne i kemi njoftuar palët me vendimet e bordit dhe kemi kërkuar plotësimin e dokumentacionit për ti përcjellur përsëri në shqyrtim .

Në verifikim janë kthyer 5 lëndë :

- Dy (2) lëndë për riparim shtëpie dhe
- Tri (3) për plan biznesi.

Është kryer verifikimi i tyre në teren nga koordinatori për kthim, koordinatori rajonal dhe zyrtari për riintegrim në MPB

Nga komisioni komunal për riintegrim janë shqyrtuar edhe kërkesa tjera të cilat janë rekomanduar për miratim në Sekretariatit e bordit për riintegrim përmes koordinorit rajonal. Kemi edhe kërkesa tjera të paraqitura për të cilat kërkohet kompletim i dokumentacionit nga palët.

Po ashtu, gjatë këtij viti jemi angazhuar për të ndihmuar një pjesëtare të komunitetit rom për të cilën kemi siguruar dru dhe pako ushqimore.

Kemi marrë pjesë në takime koordinuese regjionale për riintegrim, trajnime dhe punëtori lidhur me integrimin evropian dhe riintegrimin e personave të riatdhesuar.

Jemi duke punuar në krijimin e databases për personat e riatdhesuar .

Kemi punuar në pyetësorët e MAPL-ës lidhur me implementimin e veprimeve të PVPE-së në nivel lokal dhe i kemi përcjellur brenda afatit të caktuar kohor në organet qendrore.

►Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme edhe gjatë këtij viti ka bërë punë efikase në kryerjen e shërbimeve administrative konform ligjeve, udhëzimeve administrative, rregulloreve dhe statutit të Komunës.

Aktivitetet e Drejtorisë janë realizuar përmes skemës organizative e cila përfshihet në 5 sektorë:

- Qendra për Shërbim të Qytetarëve
- Zyra e Gjendjes Civile
- Sektori i Arkivit
- Sektori Teknik dhe
- Njësia e përkthimit

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme në bashkëpunim me ministrinë përkatëse si me MPB, MAP dhe MAPL e ka rritë cilësinë e punës me futjen e programeve të reja, pajisjeve teknologjike e mjeteve tjera të punës.

Qendra për Shërbim të Qytetarëve

Qendra për Shërbim të Qytetarëve (QSHQ) gjatë tërë vitit ka qenë në shërbim të gjithë qytetarëve. Përmes Qendrës janë pranuar dhe proceduar të gjitha kërkesat që parashtrohen nga qytetarët.

QSHQ edhe këtë vit ka pasur një angazhim maksimal dhe ka ofruar shërbime cilësore e të shpejta për të gjithë qytetarët, në përputhje me udhëzimet, rregulloret dhe ligjet në fuqi.

Po ashtu, përmes Qendrës, qytetarët kanë marrë informacionet e duhura.

Edhe këtë vit në QSHQ ka funksionuar një sportel i veçantë për qytetarët tanë mërgimtarë që ka mundësuar kryerjen më të shpejtë të shërbimeve për ata. Ka vazhduar të zbatohet pranimi i kërkesave dhe procedimi i tyre në mënyrë elektronike, që nënkupton se qytetarët vetëm duhet të prezantojnë të dhënat e tyre para nëpunësit.

Gjatë këtij viti nga qytetarët janë pranuar gjithsej **32,525** kërkesa të përgjithshme, prej tyre **24,168** kanë qenë të Gjendjes Civile ndërkaq **8,357** kanë qenë kërkesa tjera që u janë adresuar drejtorive përkatëse.

Po ashtu gjatë këtij viti kemi përfituar një donacion nga USAID-i për rregullimin e QSHQ dhe furnizimin e saj me pajisje të teknologjisë informative dhe inventar. Po ashtu, përmes projektit janë mbështetur edhe Zyrat e Gjendjes Civile në teren, përkatësisht furnizimi i tyre me pajisje të teknologjisë informative dhe inventar. Projekti është në realizim e sipër, ndërsa do të finalizohet në fillim të vitit 2013. Për renovimin e objektit janë shpenzuar gjithsej 20 mijë euro nga buxheti i Komunës ndërsa furnizimi me pajisje dhe inventar do të bëhet me bashkëfinancimin e USAID-it dhe Komunës në shumën e përgjithshme rreth 50 mijë euro, prej të cilave USAID-i do të dhuron 28,350 euro dhe Komuna e Kaçanikut, 22,170 euro.

Zyrat e Gjendjes Civile

Në këtë raport është pasqyruar puna e shërbimit të Gjendjes Civile për periudhën Janar – Dhjetor 2012 për zyrat e Gjendjes Civile : Kaçanik, Doganaj, Kaçanik i Vjetër, Dubravë, Gilloboçicë dhe Ivajë. Shërbim i Gjendjes Civile ka gjithsej 9 punëtorë që e udhëheq shefi i Gjendjes Civile.

Ky shërbim gjatë periudhës Janar-Dhjetor është angazhuar që në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligjeve në fuqi, Rregulloreve dhe Udhëzimeve Administrative, Statutit të Komunës, si dhe të planit të punës, t'i kryej obligimet e veta ndaj qytetarëve. Ka vazhduar përshkrimi i librave në LAL, LAM dhe LAV të Gjendjes Civile, si dhe në riformulimin e librave të cilat janë zhdukur apo asgjësuar gjatë luftës. Risi gjatë këtij viti ka qenë skanimi i të gjitha librave (LAL, LAM dhe LAV) në një program unik. Programi mundëson që zyrtari të qaset në mënyrë më të lehtë të dhënave të kërkuara.

Zyrat e Gjendjes civile në teren kanë qenë funksionale dhe kanë kryer të gjitha shërbimet e kërkuara nga qytetarët. Kohë pas kohe janë shfaqur edhe probleme teknike të cilat janë evituar shpejt dhe me kohë. Zyrat e terrenit janë në koordinim të vazhdueshëm me qendrën dhe monitorohen në vazhdimësi. Synim yni i vazhdueshëm është krijimi i kushteve sa më cilësore në Zyrat e terrenit. Sivjet kemi arritur që të përfitojmë një donacion nga CDF (Fondi për Zhvillim të Komuniteteve), një organizatë joqeveritare që financohet nga Banka Botërore. Pjesë e projektit ka qenë edhe ndërtimi i bibliotekës, tri zyre, salla për takime të ndryshme dhe kthina tjera

përcjellës. Për realizimin e projektit CDF ka financuar 65,520 euro dhe Komuna e Kaçanikut shumë prej 24,100 euro ndërkaq projekti është kontraktuar në shumë e përgjithshme prej 89,620 euro.

Në këtë Raport nuk mund të pasqyrohen të gjitha punët, sidomos ato të kryera me palë, dhënia e sqarimeve të ndryshme si dhe udhëzimeve të cilat u jepen palëve për kryerjen e shërbimeve në Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe në Ambasadat e shteteve të ndryshme të përfaqësuara në Kosovë.

Vazhdimisht i'u është kushtuar kujdes punës me palë, sidomos me qytetarët tanë që gjenden përkohësisht në botën e jashtme. Atyre gjithnjë i'u është dhënë përparësi në kryerjen e punëve administrative.

Gjatë kësaj periudhe kohore janë kryer **24,168** lëndë të gjendjes civile:

Raporti ne formë tabelore për zyrat e Gjendjes Civile ne Komunën e Kaçanikut

1. Regjistrimi i lindjeve të rregullta	9
2. Regjistrimi i lindjeve me vonesë.....	33
3. Regjistrimi i martesave.....	341
4. Regjistrimi i rregullt i vdekjeve.....	113
5. Regjistrimi i mëvonshëm i vdekjeve.....	35
6. Certifikata të lindjes.....	10382
7. Certifikata të martesës.....	2484
8. Certifikata të vdekjes.....	405
9. Status martesor.....	749
10. Certifikata që personi është në jetë.....	439
11. Deklarata të bashkësisë familjare.....	1470
12. Certifikata të shtetësisë.....	3882
13. Certifikata të vendbanimit.....	3476
14. Vërtetime të ndryshme.....	68
15. Vërtetim për mjete materiale.....	42
16. Aktvendime të ndryshme.....	79
17. Ç'lajmërim vendbanimi.....	103
18. Regjistrimi në librin e shtetësisë për humbje shtetësie.....	58

Gjithsej: 24,168 lëndë të kryera

Spektori i Arkivit

Spektori i Arkivit Komunal veprimtarin e vet punuese e mbështetë kryesisht në hulumtimin, grumbullimin, përpunimin, klasifikimin, sistematizimin, regjistrimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e lëndës arkivore.

Gjatë periudhës kohore Janar – Dhjetor 2012 Spektori i Arkivit ka punuar si në vijim :
Arkivimin elektronik të dokumenteve: 16.164 lëndë.

Janë pranuar, klasifikuar, sistemuar dhe rregulluar gjithsej 98 regjistrator të Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit e Mbrojtjes së Ambientit.

Janë pranuar, klasifikuar, sistemuar dhe rregulluar lëndë të shtetësisë të viteve 2010, 2011 dhe 2012 nga Zyra e Gjendjes Civile.

Sistemimi në depo i fondit BF1 (Kuvendi i Komunës - Kaçanik) nga viti 1945-1999, gjithsej 208 kutia.

Sistemimin e fondit të Organizatave Shoqërore-Politike të viteve 1980-1989, gjithsej 37 kutia, ky fond është sistemuar dhe klasifikuar sipas njësive organizative të punës.

Fondi i Këshillit të Vetëfinancimit i cili ka vepruar gjatë periudhës 1992-1998, gjithsej 13 kutia.

Fondi Këshilli i Qeverisë së Përkohshme për dëmet e luftës, 11 kutia.

Arkivimi i materialeve nga shtypit e djegura gjatë luftës, 23 kutia.

Hulumtimi dhe grumbullimi i materialit dokumentues 1946-1999, gjithsej 15 kutia.

Janë hapur 149 dosje për viktimat civile të luftës 1998/1999 (me dokumente të shkruara ,fotografuara dhe,mikrofilmuara me gjithsej mbi 800 faqe dëshmi).

Është asgjësuar material i pavlefshëm të cilit ju ka kaluar afati dhe si të tilla nuk e kanë cilësinë e lëndës arkivore dhe nuk janë funksionale.

- Gazeta zyrtare të ish Jugosllavisë të cilat nuk janë funksionale .
- Kërkesa për nxjerrjen e certifikata të ndryshme, pushimi vjetor dhe kërkesa të pa realizuara .
- Vërtetime të ndryshme të studentëve për vendosjen në konvikte etj.
- Materiale të ndryshme për trajnimet e zyrtarëve komunal etj.

Gjithashtu janë kryer edhe punë me palë, duke iu ofruar shërbime profesionale konform ligjeve në fuqi si atij për Qasje në Dokumente Zyrtare dhe Ligjit për Arkiv .

Njësia e Përkthimit

Njësia e përkthimit ka bërë përkthimin e dokumentacioneve nga gjuha serbe ne atë shqipe dhe anasjelltas.

Gjatë periudhës Janar – dhjetor 2012 janë përkthyer këto lloj dokumente:

- Përkthimin e lëndëve te ndryshme
- Përkthimin e tenderëve .
- Përkthimin e kontratave.
- Përkthimin e konkurseve te ndryshëm
- Përkthimin e Ueb faqes komunale në gjuhen serbe.

Përkthimin e vendimeve te ndryshme te kuvendit komunal dhe përkthimin e te gjithë dokumenteve komunale dhe gjithë këto dokumente janë të ruajtura ne mënyrë elektronike.

Spektori Teknik

Spektori teknik përbëhet prej 6 punëtorëve dhe shefit te sektorit.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2012 janë kryer këtë punë teknike si në vijim:

- Mirëmbajtja dhe pastrimin i objektit brenda dhe jashtë.
- Shpërndarjen e postës së jashtme dhe të brendshme.
- Mirëmbajtjen dhe rregullimin e nxehtes qendrore.
- Kujdesin për furnizim me derivate të nxehtes qendrore dhe gjeneratorit dhe
- Riparimet e vogla që ndodhin në objektin komunal etj.

Gjatë vitit ky sektor është angazhuar në punët tjera si pastrimin e varrezave të dëshmorëve, vendosjen e flamujve në raste të festave të ndryshme si dhe stolisjen e tërë qyteti me flamuj kombëtarë dhe shtetëror si dhe punë tjera teknike sipas nevojës etj.

► Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Gjatë periudhës një vjeçare Janar- Dhjetor 2012 Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka qene e angazhuar qe përmes QKMF dhe QPS të beje ofrimin e shërbimeve sa me cilësore dhe efikase në shëndetësi, shërbime sociale dhe inspektim higjeno sanitar .

Ne këtë raport janë përfshirë të gjitha aktivitetet që janë kryer gjatë këtij viti ne shërbimet shëndetësore, shërbimet sociale dhe inspektim higjiene-sanitar.

Shërbimet primare shëndetësore

Në kuadër të Drejtorisë nuk ka pasur asnjë ndryshim ne stafin punues ,është punuar me 4 (katër) punëtor duke e llogaritur edhe Drejtorin e Drejtorisë . Edhe ne QKMF (Qendra kryesore e Mjekësisë Familjare) ka pasur disa zëvendësime ,për shkak se disa mjekë kanë vazhduar specializimin , por numri i stafit punues nuk ka ndryshuar mbetet i njëjtë me vitin e kaluar 103. Gjatë vitit 2012 të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare kanë qenë të mbuluara me mjekë. Është implementuar mjekësia familjare në të gjitha qendrat e mjekësisë familjare megjithëse ende kemi nevojë për mjekë familjar .Janë mbajtur trajnime të rregullta ku janë mbajtur ligjërata për zhvillimin e vazhdueshëm profesional. Sektori i emergjencës ka funksionuar në mënyrë të rregullt gjatë 24 orëve për çdo ditë ku janë ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme pacientëve . Edhe në sektorin gjinekologjisë ka pasur një angazhim të theksuar ku janë bere kontrollime te rregullta dhe janë dhëne këshilla profesionale për nenat shtatzëna nga gjinekologjia. Një numër të madh të pacientëve gjatë këtij viti kemi pasur edhe në sektorin e pediatriisë ku mjeku pediatër ka trajtuar shumë pacient.

Të gjitha shërbimet primare shëndetësore kanë qenë nën kontrollin e vazhdueshëm te koordinatorit të shërbimeve cilësore i cili është i zgjedhur në bazë të ligjit për shëndetësi .

Si zakonisht edhe gjatë këtij viti kemi raportuar për sëmundjet ngjitëse dhe kancerogjene në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë në Ferizaj.

Është realizuar vaksinimi në bazë të planit për të gjithë pacientët që kanë qenë të paraparë për vaksinim. Plani i vaksinimit gjatë këtij viti është realizuar mbi 90%.

Ne vijim te këtij raporti te gjitha shërbimet janë te paraqitura edhe ne mënyrë statistikore për çdo shërbim veç-veç.

Ka vazhduar bartja e pacientëve me dializë në spitalin e Gjilanit . Është bërë përpjekje që gjatë këtij viti të bëhet transferimi i pacientëve me dializë nga Gjilani në Ferizaj, por një gjë e tillë nuk është arritur, janë bere shume takime me Ministrin e shëndetësisë dhe Drejtorin e Spitalit regional te Ferizajt për këtë qellim, pritet qe gjate muajit janar te vitit 2013 te behet ky transferim.

Furnizimi me barna esenciale nga Ministria e Shëndetësisë ka qenë me i mire se vitet tjera. Vlen të theksohet se gjatë këtij viti është bere renovimi i hapësirës se laboratorit dhe është pajisur me inventar te nevojshëm, ky renovim është bere nga shoqata Irlandeze vlere e këtij donacioni ka qene rreth 6000 ero. Merita për këtë donacion i ka Zonj. Mary Packer e cila nuk është hera e pare qe na ka ndihmuar ne rregullimin e kushteve te punës ne QKMF.

Gjate këtij viti është ndërtuar dhe lëshuar ne funksionim AMF ne fshatin Ivajë ,donacion nga Halil Luta bashkëfshatarë i këtij fshati i cili punon ne boten e jashtme, vlere e këtij projekti sipas donatorit ishte rreth 20.000 euro. Inventarin për këtë objekt shëndetësor e kemi siguruar ne nga QKMF.

Vlen te ceket se edhe nga Caritasi i Luksemburgut gjate këtij viti kemi marre disa pajisje manuale dhe doracak shume te nevojshme për te gjitha QMF dhe AMF.

Po ashtu gjatë vitit 2012 në QKMF është bërë renovimi , ndërrimi i dyerve dhe dritareve ne katin e I (pare) nga buxheti i drejtorisë se shëndetësisë ne vlere prej 9.974.50 ero.

Në kuadër të Drejtorisë SHMS gjatë vitit 2012 janë përgatitur dokumentacione te nevojshme për 26 palë për trajtim mjekësor jashtë vendit të cilat janë përcjellë në MSH.

Drejtoria gjatë këtij viti ka ndihmuar 20 raste për trajtim mjekësor dhe ndihma momentale në të holla në shumë prej 33 -200 €.

Shërbimet shëndetësore të kryera gjatë vitit 2012

Në sektorin e mjekësisë Familjare	38600
Sektori i Emergjencës	56195
Sektori i Stomatologjisë	16975
Sektori i Pediatriisë	6546
Sektori i Lindjes	1
Sektori i Pulmologjisë	1078
Shëndeti Mental	2930
Në këshillimoren e grave	10501
Në shërbimin e vaksionimit	10392
Sektori Laboratorik	8781
Sektori i rëntgenit.....	4732
EKG.....	1091
Intervenimet ne QMF dhe AMF	9416

Shërbimet e kryera në QMF dhe AMF

Në QMF – Doganaj	1210
Në QMF - Kaçanik i Vjetër	180
Në QMF - Gllloboçicë	1272
Në QMF - Bob.....	324
Në AMF – Stagovë	749
Në AMF - Begracë	1744
Në AMF - Biçec.....	484
Në AMF - Dubravë	1099
Në AMF - Kotlinë	592
Në AMF - Stazhë	972
Ne AMF - Ivajë	172
Totali i shërbimeve në QKMF	176036

Shërbimet Social

Gjatë vitit 2012 Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale përmes Qendrës për Punë Sociale (QPS) ka ofruar shërbime sociale në mënyrë të rregullt.

Në stafin punues te QPS nuk ka pasur ndryshime, kanë punuar 8 punëtor me Drejtorin QPS. Drejtoria përmes QPS është përpjekur maksimalisht që konform ligjeve të aplikueshme tu ofroj shërbime të nevojshme sipas kërkesave të palëve, ku të gjitha kërkesat e palëve janë shqyrtuar dhe u është përgjigjur me kohë dhe sipas Ligjit. Gjate vitit 2012 kemi marre pjese ne Trajnimin për decentralizimin e shërbimeve sociale te financuar nga DFID-i Mbretërisë se Bashkuar. Ky trajnim është mbajtur ne pese (5) Module prej muajit Maj deri ne Shtator te vitit 2012. pritet qe gjate vitit 2013 ky decentralizim i shërbimeve sociale te hyj ne fuqi neper QPS.

Të gjitha shërbimet sociale janë kryer nga dy ekipet që kanë funksionuar në QPS:

Ekipi i shërbimeve sociale dhe Ekipi i asistencës sociale

Ekipi i shërbimit sociale kujdes të veçantë i ka kushtuar fëmijëve pa kujdesin prindor, numri i tyre ka qenë 25, ku 11 prej tyre janë mbështetur materialisht me nga 75 € në muaj, ndërsa 14 fëmijë kanë gëzuar asistencën sociale.

Fëmijë të braktisur gjatë vitit 2012 ka pasur një (1) fëmijë të adaptuar, 2 të braktisur një gjinisë mashkull dhe një i gjinisë femër i cili është në strehim familjar. Kërkesa për birësimin – adaptimin e fëmijëve kemi pasur 1 rast .

Gjatë këtij viti jemi ballafaquar me 4 fëmijë ndaj të cilëve prindërit nuk kanë treguar kujdes të duhur ,ku këta fëmijë janë hasur në rrugë duke kërkuar lëmsh, dhe të gjithë këta fëmijë janë nga Shqipëria dhe banor të përkohshëm në Kosovë.

Fëmijët e familjeve në konflikt që janë trajtuar nga QPS kanë qenë 13 fëmijë nga 7 qifte bashkëshortore, është bërë sanimi i marrëdhënieve të këtyre rasteve dhe kontrollohen nga ekipi i shërbimeve sociale .

Fëmijët me sjellje asociale kemi pasur 3 raste me të cilët është punuar së bashku me drejtorinë shkollës dhe prindërit e tyre .

Delikuent të mitur kemi trajtuar 36 raste të cilëve u është dhënë këshilla nga ekipi I shërbimeve sociale .

Fëmijë dhe të rinjë me nevoja të veçanta , gjatë këtij viti kanë qenë 77 raste që kanë gëzuar të drejtën në kompensim material prej 100 € në muaj,këtë vit kane aplikuar 15 raste prej tyre 6 janë pranuar, 6 janë refuzuar kurse 3 të tjerë kanë mbetur në shqyrtim .

Vlen të cekët se gjatë këtij viti në komunën tonë ka funksionuar mësimi special në shkolla ku janë përfshirë 15 fëmijë .

Trafikim të qenieve njerëzore në komunën tonë gjatë këtij viti nuk kemi pasur .

Të rriturit me nevoja të veçanta janë evidentuar një numër i madh ,një pjesë e të cilëve janë përfshirë në asistencë sociale, një pjesë e tyre në shërbimet e administratës pensionale, disa janë këshilluar të vizitojnë qendrën e shëndetit mental në Ferizaj me qëllim që të trajtohen në mënyrë adekuate .

Të rriturit në gjendje konfliktuoze kemi pasur 9 raste të cilat janë trajtuar nga ekipi I shërbimit social.

Dhuna në familje është paraqitur dhe trajtuar në 6 raste. Të gjitha këto raste janë trajtuar në bashkëpunim me Gjykatën ,Shërbimin Policor, Zyrën për mbrojtjen e viktimave, Institutin për punë sociale, Departamentin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, OJQ, spitalet, shkollat, shtëpinë e pleqve etj.

Nga evidence që është mbajtur rregullisht nga ekipi i asistencës sociale sipas muajve kemi radhitur shfrytëzuesit e ndihmave sociale: Janar 794 familje, Shkurt 800 familje, Mars 818 familje, Prill 773 familje, Maj 824 familje, Qershor 802 familje, Korrik 803 familje, Gusht 791 familje, Shtator 783 –familje, Tetor 685 familje, Nëntor 766 familje dhe Dhjetor 778 familje.

Mesatarja mujore ka qenë 784 familje të cilat kanë shfrytëzuar ndihmat sociale .

Drejtoria edhe këtë vit ka bërë kërkesë MPMS për ndërtimin e një objekti për banim social, por nuk ka pasur asnjë përgjigje .

Inspekcioni Sanitar

Janë bërë inspektime të rregullta të të gjitha subjekteve afariste të cilat prodhojnë, përpunojnë dhe shesin artikujt ushqimor për konsumator, institucionet edukativo –arsimore etj.

Gjatë vitit 2012 Inspektori sanitar ka lëshuar 11 pëlqime sanitare për lokacion dhe ndërtim vlere e të cilave ka qene ne shume prej 551.50 ero.

Komisioni komunal (inspektori sanitar dhe i tregut), kanë bërë pranimin teknik hijeno sanitar të 60 subjekteve afariste në shumë prej 2.400 €.

Janë marrë masa dhe janë shqiptuar dënime mandatorë ndaj subjekteve afariste që nuk kanë respektuar rregullat sanitare –në shumë prej 675 €.

Është bërë asgjësimi i mallit me afat të skaduar në vlerë prej 759.30 €.

Është përcjellur vazhdimisht gjendja e kualitetit të ujit të pijshëm të ujësjellësit qendror, si nga aspekti kimik dhe bakteror, ku janë marre 100 mostra për analiza, është përcjellë gjendja shëndetësore e punëtorëve ndaj bacilbartësve që merren me shitjen dhe distribuimin e artikujve ushqimor .

Të gjitha furrat e bukës dhe restorantet gjatë këtij viti kanë kryer D.D.D

Në bashkëpunim me Agjensionin e Ushqimit janë kryer disa inspektime nëpër subjektet afariste ku janë urdhëruar me aktvendime për eliminimin e të metave dhe përmirësimin e kushteve hijeno – sanitare si dhe rregullimin e hapësirave për duhan pirës .

Në bashkëpunim me Inspektorin e Shërbimeve Publike është inspektuar tregu i gjelbër për çdo të premtë (ditë tregu) dhe është bashkëpunuar ngushtë me Shërbimin policor – , Doganat e Kosovës ,në shumë raste e veçmas në kontrollimin e automjeteve që transportojnë ushqim .

Gjatë vitit 2012 ka pasur 58 kërkesa të adresuara pranë zyrës së inspektionit sanitar te cilat janë shqyrtuar dhe janë kryer sipas detyrës zyrtare .

Ne këtë Drejtori janë bere planet e punës për vitin 2013 si dhe është raportuar për punën e kryer për vitin 2012.

► Drejtorja e Arsimit e Kulturës

Mbi suksesin e nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme, orët e pa mbajtura të nxënësve e arsimtarëve në fund të vitit shkollor 2011/2012, si dhe vlerësimet jashtme te semimaturantëve dhe maturantëve.

DKA, si organ menaxhues për çështje të edukimit dhe arsimit edhe më tej fuqimisht mbështet përkujdesjen për ngritje të cilësisë në procesin mësimor, duke implementuar reformat në mësimdhënie dhe mësimnxënie përmes pjesëmarrjes aktive të arsimtarëve në trajnime enkas për këtë qëllim.

KAPTINA E PARË

Duke u bazuar në planin dinamik të punës, obligimet dhe përgjegjësitë e sektorit të arsimit në organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor në komunë, janë bërë të gjitha përpjekjet profesionale në eliminimin e dobësive , problemeve me qëllim të ngritjes së cilësisë në mësim dhënie dhe mësim nxënie.

Përgjegjësitë e mia në cilësinë e zyrtarit për arsim para fillor dhe fillor, më kanë obliguar në planifikimin e aktiviteteve për t'u ballafaquar me të gjitha sfidat që e përcjellin arsimin në komunë. Natyra e punës ka ndikuar që më tepër aktivitetet të orientohen në teren për të marr informata në mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Rëndësi e veçantë duhet kushtuar kontakteve, takimeve me mësimdhënës si proces i aktiviteteve në zbatimin e plan-programit mësimor.

Objektivat

Përfshirja e fëmijëve në edukimin parashkollor; dhe fillor; Zbatimi i plan – programit mësimor; Përgatitja me shkrim e mësimdhënësve për orë mësimore; Vlerësimi i njohurive të nxënësve; Trajnimi i mësimdhënësve si proces i ngritjes profesionale dhe Funksionimi i aktiveve profesionale.

Karakteret e vizitave

Për të pasur një pasqyrë reale për gjendjen në mbarëvajtje e procesit mësimor, janë hartuar planet e vizitave nëpër shkolla, për të njoftuar drejtpërdrejt me problemet me të cilat ballafaqohet shkolla (mësimdhënësit, nxënësit) në zbatimin dhe realizimin e plan-programit mësimor.

Për vizitat e realizuara nëpër shkolla, llojin e tyre dhe aktivitete tjera, japim këtë pasqyrë.

Lloji i vizitave	Vizita të përgjithshme	Vizita speciale	Takime pune	seminare	intervista	Komisione dhe debate
Numri i vizitave	20	15	8	3	4+1	2
	Bëhet një kontrollim I dokumentacionit pedagogjik dhe monitorim në orë mësimore.	Bëhet sipas planit por edhe sipas nevojës, për të konstatuar gjendjen reale në shkollë	Janë mbajtur në nivele komunale dhe të shkollave	Dy seminare në Durrës dhe një në sh.f “Qamil Ilazi”, paralelja në Çardak	Janë mbajtur në tri shkolla, Bren da vitit mësimor dhe një në muajin gusht 2012	Një takim me komisionin për rregulloren e SHML dhe në debat të asamblesë komunale

Vizitat e realizuara nëpër shkolla kanë pasur për qëllim zbatimin e plan-programit mësimor dhe ngritjen e cilësisë në procesin mësimor.

Vizitat e përgjithshme, janë realizuar sipas plan-programit, i bazuar sipas specifikave të shkollave (paralelet e ndara fizike me mësim të kombinuar), mungesës së vizitave nga SIA-Ferizaj, ngase sektori inspektimit në Ferizaj, brenda vitit mësimor inspekton vetëm dy shkolla. Për shkak të nevojave pedagogjike dhe metodike të mësuesve të mësimit klasor, këto vizita kanë pasur për qëllim: ndihmën profesionale në eliminimin e dobësive për mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor. Vizitat kanë qenë të orientuara në mësimin para fillor dhe fillor (mësimi klasor)

Për vizitat e realizuara janë dhënë rekomandime të afatizuara dhe nga vizitat kontrolluese është konstatuar shkalla e eliminimit të tyre.

Vizitat speciale, realizohen sipas plan-programit por edhe sipas nevojave eventuale që paraqiten nëpër shkolla Vizita speciale kemi pasur në të gjitha shkollat, por më e theksuar ka qenë shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Ali Asllani”, ngase në këtë shkollë ka qenë i organizuar mësimi jo formal (me të rriturit), ndërsa unë kam qenë i caktuar si përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit mësimor Në këtë kontekst do të përmendi vizitën e realizuar në SHFMU “Idriz Seferi” me 06.04.2012 si rezultat i çrregullimit të orarit mësimor në mësimin klasor. Për këtë çrregullim ka pasur reagime në asamblenë komunale Bazuar me gjendjen reale, është hartuar raporti me të cilin është njoftuar drejtorja e shkollës, ndërsa gjendja është normalizuar.

Edukimi parashkollor. - Në të gjitha shkollat fillore është organizuar edukimi parashkollor, dhe i kompletuar me kuadro profesional dhe me një ngritje të vazhdueshme profesionale (është fjala për edukatorët me SHLP)

Kushtet e punës. - Në përgjithësi kushtet janë të mira, pos në shkollë fillore “Idriz Seferi” paralelja në Kovaçec. Në këtë paralele mungojnë kushtet elementare; mungon klasa, pajisjet,

ndërsa fëmijët mësojnë në mes dy ndërrimeve prej orës 12:00-13:00, që nuk është në harmoni me ligjin për arsim parafillor.

Në shkollën fillore “Gafur Luma” në Gllloboçicë, klasa për parashkollor nuk është sipas standardeve, mungojnë rregullimi i brendshëm i klasës si dhe pajisjet.

QEAP “Agimi”.-Posedon me kushte të mira, hapësira e brendshme i plotëson standardet.

Në këtë institucion, mësojnë edhe parashkollorët e moshës 5-6 vjet, për shkak të mungesës së lokalit në shkollën fillore “Emin Duraku”.

Kuadri arsimor është kualifikuar dhe i plotë sipas udhëzimit administrativ nr.17/2012, ngase ky udhëzim e ndryshon numrin e fëmijëve në raport me edukatoren.

Në QEAP”Agimi”, mungon infrastruktura e jashtme, andaj, ambienti jashtëm ia humb pamjen.

Takime pune janë mbajtur me inspektorët rajonal- SIA-Ferizaj,gjatë inspektimeve nëpër shkolla, përfaqësuesit e Caritasit, QPEA- Ferizaj,me drejtoreshën e shkollës amerikane në Kosovë z.Igballe Blakaj, DKA-së, me drejtorët e shkollave, me stafin e mësimdhënësve, me mësimdhënës, nxënës etj.

Takimet me SIA-Ferizaj, kanë pasur për qëllim që të krijohet një pasqyrë reale e gjendjes në mësimdhënie dhe mësimnxënie, për të ardhur te indeksi i nevojave të mësimdhënësve dhe nxënësve.

Takime me Caritasit.- Caritasi , ka ndihmuar (grante) arsimin në komunën e Kaçanikut në forma të ndryshme (janë ndihmuar me pajisje, sipas përcaktimeve të shkollave, me vlerë 3000 euro për secilën shkollë, pos Çerdhes që s,ka qenë e përfshirë). Pos kësaj janë ndarë bursa për nxënësit e shkollës së mesme të lartë. Ndarja është bërë sipas kriterëve të përcaktuara. Në bazë të kriterëve të përcaktuara, kanë përfituar dymbëdhjetë nxënës maturant burse me vlerë 40 euro në muaj.

Takim me QPEA –Ferizaj.-Në nivel të regjionit të Ferizajt është organizuar një garë për një projekt “Hapësira të gjelbëruara”, në të cilën kanë marrë pjesë të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të ulëta në nivel rajonal. Në bazë kriterëve, komisioni, si punime më të mira i zgjedh punimet e këtyre shkolla: “Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Emin Duraku”, “Idriz Seferi” dhe “7 Shtatori”, këto shkolla kanë marrë pjesë në seminarin dy ditor që është mbajtur në Durrës.

Takime punee me drejtoreshën e shkollës amerikane, për caktimin e tri shkollave fillore dhe të mesme të ulët për gara në nivelin shtetëror. Nga komuna e Kaçanikut për gara në nivelin shtetëror u caktuan këto shkolla: “Emin Duraku”, Idriz Seferi” dhe “Kadri Zeka”.

Takime me drejtorët e shkollave, janë mbajtur në nivel të aktivitetit të drejtorëve por edhe në nivele shkollore, me rastin e vizitave të shkollave. Në çdo vizitë , në fund është mbajtur një takim me mësimdhënës. Në këto takime është shqyrtuar, vlerësuar mbarëvajtja e procesit mësimor si dhe janë analizuar shkaqet e ngecjeve për të hulumtuar teknika strategjike të punës në ndjekjen e trendeve për të ofruar një arsimim sa më cilësorë fëmijëve para shkollor, nxënësve të shkollës fillore.

Prioritet. - Duke u nisur nga specifikat e shkollave (shkollat me paralele të ndara), mungesës së vizitave nga SIA-Ferizaj, vlerësimit të jashtëm, vështirësive në menaxhim dhe nevojave profesionale të mësimdhënësve dhe punës së pamjaftueshme të aktiveve profesionale, edhe më tutje me prioritet mbeten paralelet e ndara.

Paralelet e ndara ballafaqohen: me mungesën e kuadrit profesional, me mësim të kombinuar, mungesës së monitorimit në orën mësimore dhe vlerësimit të jashtëm.

Përgatitja me shkrim e mësimdhënësve është proces i hulumtimit të metodologjisë së mësimdhënies, duke ndjekur trendet bashkëkohore. Përcaktimi i qëllimit dhe objektivave për temën mësimore mbetet sfida të mësimdhënësit. Gjatë monitorimit në orën mësimore të analizohen dhe vlerësohen përgatitjet me shkrim të mësimdhënësve.

Aktivitetet garuese në nivele komunale rajonale dhe shtetërore

Jemi përballur me aktivitete pune të cilat nuk kanë qenë të planifikuara, por që janë pjesë e këtij sektori. Ndër aktivitetet që kanë pasur karakter garues veçojmë:

Garat e diturisë “Universiada” 2012, Garat me karakter rajonal të organizuara nga kolegji “Mehmet Akif”, Garat e nxënësve të klasave të para, të organizuara në kuadër të MASHT-it për festën e Abetares; Gara në nivelin shtetëror, organizuar nga shkolla amerikane në Kosovë, Garat në nivel të rajonit me klasat e pesta në projektin KOSOVIION CONTEST, Garat në kolegjin amerikan “Olimpiada e diturisë 2012”

Garat e organizuara nga Komisioni Evropian “Evropa më afër”, Garat komunale të diturisë

Rezultatet e arritura në gara

Në këto aktivitete janë arritur rezultate dhe suksese me karakter rajonal dhe qendror.

Në manifestimin qendror, gjithë kombëtar të festës së Abetares, që është mbajtur me 17 prill 2012 në Prizren, rajonin e Ferizajt e ka përfaqësuar SHFMU “Emin Duraku”. Nxënësit e klasës I-rë-6 u prezantuan në programin qendror të festës së Abetares, që u vlerësua shumë i suksesshëm, ndërsa manifestimi qendror në nivel komunal është mbajtur në shtëpinë e kulturës “Xheladin Kurtaj”. Festa e Abetares ka pasur karakter mbarë kombëtar.

Garat e diturisë “Universiada” 2012, që tani janë bërë tradicionale, në nivel rajonal, në të cilën marrin pjesë rajoni i Ferizajt dhe Gjilanit. Në këtë aktivitet janë përfshirë nxënësit e klasave të V-ta, VIII-ta dhe të IX-ta të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta.

Ndër shkollat më të suksesshme në nivelin rajonal, ishte shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Kadri Zeka”, që u rangua në vendin e parë në klasën e pestë.

Në garat e organizuara nga kolegji amerikan “Olimpiada e diturisë 2012”, Komuna e Kaçanikut është përfaqësuar nga SHF dhe SHMU “Emin Duraku”, e cila zuri vendin e parë në nivelin shtetëror.

Në garat e organizuara nga Komisioni Evropian, Evropa më afër, shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Emin Duraku”, zuri vendin e tretë.

Në fund të vitit shkollor mbahet garat komunale të diturisë, që tani janë bërë tradicionale në komunën tone dhe që kanë reflektuar pozitivisht, por në këtë vit ka pasur risi në aspektin e organizimit. Në gara marrin pjesë nxënësit e shkollës së mesme të ulët. Garat janë mbajtur në këto lëndë: Gjuhë shqipe, Histori, Gjeografi, Biologji, Kimi, Fizikë dhe Matematikë.

Rezultatet e garave komunale 2012-nxënësit që janë plasuar në vende të para, sipas shkollave

Nr.	Emir dhe mbiemri	Shkolla	Lënda	klasa
1	Admir Rrahmani	“Emin Duraku”	Biologji	VII
2	Gent Koxha	“Emin Duraku”	Matematikë	VII
3	Fitim Bela	“Emin Duraku”	Fizikë	VI
4	Lorik Loku	“Emin Duraku”	Fizikë	VII
5	Leutrim Loku	“Emin Duraku”	Gjuhë shqipe	VI
6	Delvina Zeneli	“Idriz seferi”	Matematikë	VIII
7	Qëndresa Zeneli	“Idriz Seferi”	Fizikë	VIII
8	Laureta Zeneli	“Idriz Seferi”	Gjuhë shqipe	VII
9	Dorarta Malsiu	“Kadri Zeka”	Kimi	VII

10	Heroina Imishti	“Kadri Zeka”	Kimi	VIII
11	Lirand Berisha	“Kadri Zeka”	Matematikë	VI
12	Majlinda Selimi	“Qamil Ilazi”	Gjuhë shqipe	VIII
13	Violeta Palloshi	“Jusuf Gërvalla”	Gjeografi	VI
14	Florentina Horuni	“Jusuf Gërvalla”	Biologji	VIII
15	Nurije Koraçi	“jusuf Gërvalla”	Kimi	VIII
16	Dafina Luzha	“7 Shtatori“	Biologji	VI
17	Behar Osmani	“Nazmi Osmani”	Gjeografi	VIII
18	Diellza Ramadani	“Gafur Luma”	Histori	VI
19	Edona Kuçi	“Naim Frashëri’	Histori	VIII
20	Resmije Loku	“Naim Frshëri”	Gjeografi	VII
21	Hekuran Gashi	“ 7 Shtatori”	Histori	VII

Për nxënësit që u ranguan në vendin e pare, në nivelin, komunal, rajonal dhe shtetëror, kryetari i komunës z.Besim Ilazi i shpërbleu me një ekskursion me karakter edukativ, në qytetet historike, por me qëndrim tre ditë në Durrës.

Aktivitetet jashtë programit të punës, por që nuk planifikohen në sektorin e arsimit dhe që jemi ballafaquar gjatë këtij viti veçojmë:

Puna në komisione komunale për intervistim;

Puna për hartimin e rregullores për shkollat të mesme.

Hartimi i kërkesës për tekste shkollor

Duke pasur parasysh problemet që manifestohen te nxënësit e shkollave të mesme, u formua komisioni në nivel komunal nga mësuesit e gjimnazit dhe shkollës profesionale për hartimin e rregullores. Komisioni ka zhvilluar një aktivitet intensiv dhe ka arritur të hartoi rregulloren, e cila është debatuar dhe miratuar nga Kuvendi i Komunës.

Intervistime me mësuesit. -Jemi ballafaquar me vështirësi të natyrës ligjore, ngase konkursi për pranimin e kuadrit për vitin shkollor 2012/2013 dhe komisioni për intervistim , ka pasur shkelje të ligjit.

Hartimi i kërkesës për tekste shkollorë të nevojshme.-Është një aktivitet që i takon sektorit të administratës, por kemi qenë të ngarkuar me këtë aktivitet, që ka qenë mundimshëm ngase të gjitha kërkesat e shkollave fillore dhe të mesme të ulët, janë përpunuar katër herë në modele të ndryshme (shtëpitë botuese i ndryshonin modelin e kërkesave).

Shtëpia botuese “Libri shkollor “ ka qenë korrekt në plotësimin e kërkesave dhe nuk ka pasur mungesa teksteve, ndërsa shtëpia botuese “Dukagjini”, nuk i është përgjigjur kërkesës dhe se ka sjellë tekste që nuk janë kërkuar fare dhe që janë të pa nevojshme, për këtë jo korrektësi i është bërë vërejtje me shkrim.

Vështirësitë që më kanë përcjellur në realizimin e aktiviteteve e që ka reflektuar negativisht në sukses:

Vizitat e planifikuara sipas programit të punës, ka pasur raste që janë anuluar ose i kam realizuar me veturën time, si mungesë e veturës zyrtare dhe vullnetit të mirëfilltë;

Ka munguar analiza, vlerësimi dhe mbështetja e aktivitetit;

Hartuesit e testeve të garave komunale të diturisë nuk janë kompozuar që dy vite (kanë përgatitur testet, kanë menaxhuar testin dhe kanë bërë poentimin)

Nuk më është paguar asnjë mëditje nga dy seminarët që kemi qenë në Durrës dhe tri ditë në ekskursion me nxënësit që kanë arritur vendet e para në gara (kam qenë në cilësinë e e udhëheqësit të ekskursionit). Seminarët janë mbajtur ditëve të vikendit.

Veprimet për ngritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Duke u bazuar në mangësitë që e përcjellin mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe kërkesave profesionale kërkesave profesionale kërkojmë:

Në shkollën fillore dhe të mesme të ulët "Idriz Seferi", paralelja në Kovaçec, të krijohen kushte normale për mësimi para fillor. Në këtë shkollë, mungon klasa dhe pajisjet (nuk kemi kurrfarë pajisjesh), edukatorja pos shkumësit, nuk ka asnjë mjet tjetër. Në një gjendje të njejt është edhe shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Gafur Luma" në Gllloboçicë, ajo që e dallon, është se e ka klasën e veçantë.

Drejtorët e shkollave, zyrtarët e sektorit të arsimit dhe SIA-Ferizaj të planifikojnë më tepër vizita të karakterit monitorues në orën mësimore të mësimit klasor. Monitorimi në orën mësimore të ketë karakter këshillues për t'a ndihmuar mësimdhënësin

Të sigurohen mjete kompensimi për hartuesit testeve të garave të diturisë (të krijohet një fond i veçantë), është e mundur që garat e vitit të ardhshëm mos të mbahen.

Raportet e vizitave që bëhen nga zyrtari i arsimit të analizohen, të vlerësohen dhe të mbështeten nga organet përkatëse.

Të shikohen të gjitha mundësitë në riorganizimin e paraleleve të ndara fizike në shkollën fillore dhe të mesme të ulët "Idriz Seferi" në Bob dhe "Dituria" Ivajë. Kjo do të mundësonte një menaxhim më efikas dhe

Në shkollën fillore dhe të mesme të ulët "Naim Frashëri" Kotlinë, mësimi të organizohet me një ndërrim, pasi që mundësitë ekzistojnë.

Të rregullohet ambienti i jashtëm i QEAP "Agimi"

KAPTINA E DYTË

Edukimi dhe arsimiti i mesëm i ulët (AMU-VI-IX)

Kujdesi për zhvillimin e Arsimit të Mesëm të Ulët qëndron në nivel të duhur, si dhe vazhdon angazhimi me intensitet dhe përkushtim. Kjo dëshmohet me organizimin serioz të organeve menaxhuese të shkollave dhe cilësinë e përgjithshme në procesin edukativo-arsimor.

Funksionimi i shkollave në këtë kontekst duhet të jetë synim për rezultate praktike që imponon natyra e punës së shenjtë.

Zhvillimi i rrjetit shkollor

Bazuar në kushtet dhe mundësitë e lejuara, rrjeti i shkollave të nivelit AMU, konstatojmë se është kënaqshëm i zhvilluar.

Procesi mësimor VI-IX zhvillohet në 12 shkolla amë dhe në 9 paralele të ndara fizike.

Organizimi i punës në shkollë

Puna e organizuar në objekte shkollore është gjithë përfshirëse dhe me efekt pozitiv për nxënësit e të gjitha niveleve. Kështu, përfillen parimet shkencore pedagogjik-metodologjike. Ato u përshtaten kushteve të reja dhe pikëpamjeve bashkëkohore të mësimit. Rezultat i punës së tillë dhe respektimi i parimeve e metodave aktuale mundësojnë luftimin e verbalizimit në mësim. Këta janë faktorët që ndikojnë në gritjen e suksesit në mësim.

Krijimi i mësonjëtove bashkëkohorë ofron kushte më të mira për punë normale në të gjitha lëndët. Mirëmbajtja dhe furnizimi i tyre me mjete konkretizuese e bëjnë mësimin më të afërt për nxënësit, që është kërkesë themelore didaktike e që garanton avancim të mësimit modern.

Përpjekjet për fillim sa ma të mbarë të vitit shkollor 2011/2012 nuk munguan në asnjë shkollë të komunës.

Viti i ri shkollor filloi sipas kalendarit të përcaktuar nga MASHT, ndërsa përfundoi me një javë vonesë për arsye të shlyerjes së procesit mësimor si pasojë motit të ligë që kishte kapluar vendin tonë në muajin Shkurt 2012. Sikurse në vitin e kaluar edhe në fillimin e këtij viti shkollor, në bazë të vendimit të Qeverisë së Kosovës, përkatësisht MASHT-it, të gjithë nxënësve të arsimit fillor (nga kl. I-IX) i'u shpërndahen librat falas. Ky vendim i Qeverisë së Kosovës është për tu përshëndetur, ngase përfituesit më të mëdhenjtë do të jenë nxënësit, ndërsa në mënyrë indirekte edhe prindërit e tyre, sepse dihen kushtet e vështira ekonomike të qytetarëve tanë.

Nxënësit dhe paralelet

Numri i nxënësve në AMU gjatë viti shkollor 2011/2012 ishte 2531, prej të cilave 1228 femra ose 48.51%, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (2535 nx. '10/11), ky numër ndryshon për 4 nxënës, do të thotë që në vitin shkollor 2011/2012 në AMU janë 4 nxënës më pak. Edhe numri i femrave këtë periudhë del më i vogël nga viti paraprak për 48. Nxënësit e AMU-së janë shpërndarë në 141 paralele të plota dhe jo të plota.

Në klasat e VI-ta- janë formuar 29 paralele me 673 nx.; në kl. VII-ta 26 paralele me 573 nx.; në VIII-ta-30 paralele me 630 nx.; në IX-ta-28 me 589 nx. Pra në këtë nivel vepruan 113 paralele nëpër shkollat amë dhe 28 paralele me 232 nx.

Në nivel komune në AMU nxënësit janë shpërndarë në 141 paralele. Mesatarja e tyre në stadin komunal del 18 nx.

Suksesi i nxënësve

Prej nxënësve të nivelit AMU që vijuan mësimin dhe u vlerësuan njohurit e tyre gjithsej ishin 2382, shpreh në përqindje del 99.08%. Sukses pozitiv treguan 2340 nxënës ose 98.2%. Ndërkaq me sukses negative dolën gjithsej 42 nxënës ose 1.76%. Të pa notuar mbetën 22 nxënës ose 0.92%. Nota mesatare e këtij niveli arsimor del 3.68.

Mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të arsimtarëve

Për t'u arritur sukses i dëshiruar, komponentët e rëndësishme është vijueshmëria e rregullt e nxënësve në mësim. Ndryshe, mosvijimi i rregullt në orët e mësimin ndikon negativisht në suksesin e nxënësve. Ky faktor merret edhe si pasqyrë e mosdisiplinës së duhur në shkollë. Në fund të vitit shkollorë 2011/2012, nxënësit e nivelit AMU për të cilin flitet kanë bërë gjithsej 22408 mungesa. Prej tyre 10363 me arsye. Mesatarisht çdo nxënës ka humbur 9.32 orë mësimore. Ndërkaq, mësimdhënësit në këtë semestër gjithsej kanë humbur 1520 orë mësimore. Çdo arsimtarë ka munguar mesatarisht 4.53 orë.

KAPTINA E TRETË

Edukimi dhe Arsimi i Mesëm i Lartë (AML)

Edhe nivelit të shkollimit të AML-së i kushtohet përkujdesje e merituar, nga se pikërisht në këtë nivel merren hapat për të vazhduar me sukses studimet superior.

Kjo intencë e shkollarëve Kaçanikas vërehet dukshëm, që dëshmohet me suksesin e arritur të të rinjve.

Zhvillimi i rrjetit shkollor

Nisur nga nevojat e përgjithshme dhe mundësitë komunale, nivelin e zhvillimit të AML-së e konsiderojmë të zhvilluar nga se ekzistojnë dy shkolla të mesme me drejtime e profile për të cilat komuna ka nevojë. Kjo dëshmohet me funksionimin e gjimnazit "Skënderbeu" dhe shkollës së mesme profesionale, nga bankat e të cilave dalin quadro të afta për zhvillimin e shoqërisë përgjithësisht.

Organizimi i punës në shkollë

Edhe në nivelin e AML_së këtë vit janë bërë përgatitjet e përgjithshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. Gjatë këtij gjysmëvjetori janë bërë edhe investime të konsiderueshme në dy shkollat e mesme, sidomos në SHMP “F.Guri dhe V.Çaka”, si nga buxheti komunal , ashtu dhe nga donatorët e ndryshëm.

Procesi mësimor në vitin shkollor 2010/2011 nisi mbarë. Përpikërisht u përfill kalendari mësimor i shkoqitur nga MASHT-i. Në saje të angazhimit të organeve komunale dhe të shkollave, me kohë janë bërë përpjekje të sigurohen kushtet normale për punë.

Kuadri arsimor

Kualifikueshmëria e kuadrit mësimor për realizimin e suksesshëm të plan-programit, është faktor relevant. Sigurimit të tij edhe në këtë vit i është përkushtuar vëmendje. Kështu, në fillim të vitit shkollor në dy shkollat e këtij niveli janë angazhuar gjithsej 99 mësimdhënës. Të kualifikuar janë 97 sish ose shpreh në përqindje 97.98%, edhe në vitin paraprak ishin 99 mësimdhënës. Pra nuk duhet lënë anash përpjekjet për ngritjen e strukturës kualifikuese, nga se kështu sigurohet ngritja e cilësisë së mësimi kualitativ.

Nxënësit dhe paralelet

Në vitin shkollor 2011-2012 në dy shkollat e mesme u regjistruan 1891 nxënës (901 në gjimnazin ”Skënderbeu” dhe 990 në SHMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”), prej tyre 830 femra ose 43.89% .

Nxënësit e ri të regjistruar në këtë fillim viti dhe ata ekzistues janë shpërndarë në 62 paralele. Në gjimnazin “Skënderbeu” funksionojnë 26 paralele, kurse në SHMP 36 sish. Mesatarja e nxënësve në paralele për dy shkollat e mesme del 30.5.

Në kuadër të gjimnazit”Skënderbeu” në nivel komune veprojnë 3 drejtime me po aq profile, kurse në SHMP kemi 4 drejtime me 13 profile.

Suksesi i nxënësve

Në fillim të vitit shkollor aktual (2011-2012) në dy shkollat e nivelit të AML-së të regjistruar janë 1891 nxënës(901 në gjimnazin “Skënderbeu” dhe 990 në SHMP).Prej tyre 830 femra. Prej nxënësve të regjistruar mësimin rregullisht e vijuan 1750 nxënës (790 femra) nga ky numër nxënësish sukses pozitiv treguan 1513 nxënës ose 86.46%.

Me nota negative mbeten 237 nxënës ose 13.54%. Nga mësimdhënësit e dy shkollave të mesme është kërkuar që vlerësimi i diturive të nxënësve duhet të bëhet sistematikisht dhe objektivist. Nota mesatare e nxënësve për dy shkollat e mesme del 3.28.

Mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të arsimtarëve

Vijimi rregullt i nxënësve është faktor i rëndësishëm në procesin mësimor që ka synim nxënien e diturive të reja. Në fund të këtij viti shkollor nxënësit e nivelit të AML-së kanë bërë gjithsej 35706 mungesa, prej të cilave 27535 me arsye. Edhe pse ka një rënie bukur të madhe të orëve të humbura nga nxënësit, megjithatë kërkohet nga shkollat përkatëse që të ndërmarrin masat e duhura që ky nr.i orëve të humbura të zvogëlohet në minimumin e mundshëm. Mesatarja e orëve të humbura për nxënësit në dy shkollat e mesme del 33.44 orë. Edhe mungesat e mësimdhënësve ndikojnë negativisht në suksesin e nxënësve. Pavarësisht që numri i orëve të humbura nga ana e arsimtarëve ka një rënie në krahasim me vitin paraprak, megjithatë kërkohet që numri i orëve të humbura të zvogëlohet, në të kundërtën, DAK do të ndërmarr të gjitha masat ligjore për ta ndaluar këtë dukuri. Mesatarisht mësimdhënësit kanë humbur 11.32 orë.

Vlerësimet e organizuara nga MASHT-i

MASHT organizon vlerësime dhe testime për nivele të ndryshme të shkollimit, ndër to veçojmë Testin e Arritshmërisë për kl.e IX-ta dhe Provimin Shtetëror të Maturës.

Duke pasur parasysh mënyrën e organizimit si të Testit të Arritshmërisë ashtu edhe Provimit të maturës dhe masave të ndërmarra që rezultatet të jenë sa më reale, ne si DKA mund të jemi të kënaqur me rezultatin e tyre, pasi që edhe në testin e Arritshmërisë për kl.Ix-ta dhe Provimin e Maturës, kemi ngritje të konsiderueshme të përqindjes së kalueshmërisë. Mesatarja e kalueshmërisë në nivel komunal është 46.67, ndërsa nga 582 maturantë sa i janë nënshtruar Provimit Shtetëror të Maturës në dy afatet (Qershorit dhe Gushtit), prej tyre 423 kanë kaluar provimin ose 72.6%.

Bashkëpunimi i Drejtorisë me donatorët për ngritjen e cilësisë në arsim

Me Caritasin e Luxemburgut janë siguruar mjete teknike (për të gjitha shkollat e komunës tonë) për mirëmbajtjen e shkollave në vlerë prej 500 euro për secilën shkollë (vlera totale e donacionit 6000 euro),

Me GIZ-Gjerman, ka vazhduar trajnimi i mësimdhënësve të shkencave të natyrës dhe mësimin klasor, si dhe drejtorëve të shkollave

Me fondin monetar dhe Bankën Botërore sigurimi i granteve shkollore në vlerë prej 10 110 euro (përfutues sh.f. “Gafurr Luma” 5110.00 euro dhe sh.f. “Agim Bajrami” 5000.00 euro). Me

Suiscontact ka vazhduar trajnimi i mësimdhënësve për ngritje të kapaciteteve

Me KEC është bërë trajnimi i drejtorëve të shkollave për “Parandalimi i dukurive negative në shkolla”,(drejtorët kanë hartuar plane pune).

Rekomandime

1. Kualifikueshmëria e kuadrit kurrsesi të mos anashkalohet.
2. Të hulumtohen më tej donatorët për investime në shkolla ku ka nevojë.
3. Të vazhdojë finalizimi i punëve të papërfunduara.
4. Shkollat edhe më tej të begatohen me mjete konkretizuese mësimore.
5. T’i kushtohet kujdes furnizimit të shkollave me ujë të pijshëm.
6. Të rregullohen nyjet sanitare sipas nevojës .
7. Njohuritë e nxënësve të vlerësohen objektivisht dhe sistematikisht
8. T’i kushtohet kujdes më i madh vijimit të rregullt të nxënësve dhe mësimdhënësve.
9. Funkcionimit të bibliotekave po ashtu t’i qaset seriozisht, pa anashkaluar edhe furnizimit me tituj librash.
10. Të formohen këndet botanike me qellim të krijimit të ambientit të jashtëm dhe zbukurimit të tij.
11. Të aplikohet implementimi i reformave arsimore .
12. Të respektohet disiplina në punë reciprokisht nxënës-arsimtar.

Aktivitetet Kulturore Rinore e Sportive

Janar:

Përpilimi i planit të punës për vitin 2013 dhe raporti i punës për vitin 2012.

Përgatitjet për shënimin e 5 vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës si dhe fillimi i përgatitjeve për turneun në futboll të vogël ”Turneu i pavarësisë”.

Shkurt:

Për shkak të kushteve atmosferike,përkatësisht shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme nuk janë mbajtur aktivitete në këtë muaj.

Mars:

Aktivitete kulturo artistike me fëmijë me rastin e “Epopesë së UÇK-së. Dita e Mësuesit dhe dita e Nënës (5,6,7,8-mars)

Homazhe varrezave të dëshmorëve, ndezja e zjarreve, Pjesëmarrja SHKA-“SHQIPONJA” në manifestimin “Epojeja e UÇK-së në Prekaz.

Përgatitjet organizative për shënimin e Betejës së 9 prillit 1999 në Lagje të re dhe Rakoc.

24 mars Shënimi i përvjetorit të masakrës në Fshatin Kotlinë

Shënimi i ditës së Pranverës me një program kulturo artistik me fëmijët parashkollor të Komunës sonë.

Prill:

Program shënues kulturor për betejën e 9 prillit 1999 në Lagje të re e Rakoc

Program me pika artistike,

Turne në futboll të vogël,

Akademi përkujtimore kushtuar kësaj ngjarje.

Aktivitet përkujtimor në Gorancë në nderim të dëshmorëve: Feriz Guri dhe Xhevdet Guri të rënë me 22 prill 1999.

Dita e planetit (fanellat me mbishkrime, ekspozitë, koncert, krosi pranveror).

Maj:

Aktivitete Përkujtimore, në përkujtim të dëshmorëve:

Me 21 maj 1999, rënia e dëshmorëve: Kemajl Thaqi, në Lagje të Re dhe

Ekrem Gudaqi në fshatin Stagovë.

Me 25 maj 1999, rënia e dëshmorëve: Shaqir Kuka dhe Sakip Hysa, Lagjja Kukaj,

Sadik Guri dhe Qemajl Guri, vendi Ara e Stanit,

Fadil Bunjaku në Biçec, Abdulla Baftiu, Nazmi Osmani dhe Kemal Kolshi, Lagjja e Zharkëve.

Qershor:

1 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve dhe e Viktimave të Pafajshme të Agresionit:

Koncert për Fëmijë, Lojëra të ndryshme, Shfaqje

11 Qershori Dita e Çlirimit të Kaçanikut, Akademi përkujtimore,

Festivali tradicional i Shoqërive dhe Ansambleve Kulturo-Artistike, Ekspozitë, Turne në Futboll

Korrik:

Koncert me moton “mire se vini Mërgimtar”

Pjesëmarrja e klubit të futbollit për vajza “Kaçanikasja” në aktivitete sportive në Norvegji ne

Kampin edukativ për të rinj.

Gusht:

10 Gushti Dita e Dëshmorëve të Komunës sonë dhe Dita e Brigadës 162 “Agim Bajrami”

-Aktivitete të ndryshme kulturore e sportive, Ekspozitë e Fotografisë, Akademi Përkujtimore dhe Koktej

Shtator:

Solidarizimi me popullin amerikan - ekspozitë

Tetor:

Koncert me moton: “Uniteti i Rinisë kaçanikase”

Nëntor:

Festat e Nëntorit, Kremtimi i 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë

-Akademi. Koncerte, Shfaqje, Aktivitete Sportive dhe Defile.

Dhjetor:

Dita e personave me aftësi të kufizuara – 3dhjetori:

Program Kulturor e sportive.

Dita botërore kundër AIDS-it – Ligjërime dhe debate, Shpallja e sportistit të Vitit.

Shënim:

Ndërkohë janë organizuar e ndihmuar edhe një varg aktiviteteve e programesh të tjera në Shtëpinë e Kulturës "Xheladin Kurtaj" në Kaçanik, të organizuara nga kjo shtëpi, por edhe mbi bazën e kërkesave të grupeve dhe shoqatave të ndryshme jo qeveritare.

Në bashkëpunim me Drejtorinë, grupe, shoqëri dhe ekipe kanë marr pjesë edhe në festivale e turne të ndryshme jashtë dhe Brenda Republikës së Kosovës.

SHKA "Shqiponja" ka marr pjesë në Preshevë e Maqedoni, Gryka e Kaçanikut në Maqedoni e Shqipëri, KFF Kaçanikasja në Norvegji dhe Shqipëri etj.

Objektet Sportive

Angazhimet dhe kërkesat e DAK për infrastrukturën sportive në komunën tone drejtuar MKRS të Republikës së Kosovës etj. Edhe këtë vit klubet Sportive në mungesë të palestrës Sportive ende nuk i gëzojnë kushtet elementare për zhvillimin e ushtrimeve e të aktiviteteve garuese. Klubet shfrytëzojnë terrenin e studionit "Besnik Begunca", Sallën e edukatës fizike në Shkollën e mesme "Skënderbeu", terrenin e asfaltuar të Shkollës Filllore "Emin Duraku" dhe fushat private Sportive etj.

Shtëpia e Kulturës "Xheladin Kurtaj"

Edhe gjatë këtij viti drejtorja dhe stafi mbështetës i shtëpisë së kulturës "Xheladin Kurtaj" u angazhua për kryerjen e punëve, shërbimeve dhe detyrave tjera, si:

Përkujdesja e vazhdueshme dhe mirëmbajtja e objekteve të kulturës sado që në pamundësi realizimi të ndonjë projekti mbi bazën e investimeve kapitale, ndërkohë që është i njohur përkeqësimi i gjendjes së këtyre objekteve.

Në bashkëpunim me DAK, hartoi dhe propozoi projekte riparuese të disa lokaleve a pjesëve të këtyre objekteve.

Ofroi shërbim për të gjitha asociacionet lokale, kombëtare e ndërkombëtare, për aktivitetet e tyre (komerciale e jo komerciale) kulturore artistike, letrare, përkujtimore, politike, fetare, humane, sportive, garuese e manifestime të tjera, ndërsa vlen të theksohet kontributi për mbajtjen e festivalit të SHKA "Kaçaniku 2012".

Janë siguruar lokale për SHKA, si "Gryka e Kaçanikut", SHKA "Shqiponja" etj, për grupet e ndryshme, për SHPAK "Handikos", "Kryqi i Kuq" e për shoqata të tjera, për artistët figurative (Atelieja Artistike) për lexuesit etj. Ndërsa pas renovimit të sallës së madhe të leximit ajo vazhdon të mirëmbahet dhe shfrytëzohet për studentë dhe lexues të tjerë që e shfrytëzojnë për lexim.

Shtypi ditor në Shtëpinë e Kulturës edhe ashtu i reduktuar vetëm në tri gazeta ditore, që më par blihej për çdo ditë, tani që dy vjet është ndalur nga drejtorja e financave me arsyetim se tani ekzistojnë kompjuterët dhe nuk është e nevojshme. Përveç tjerash në Shtëpinë e Kulturës janë sjellur edhe libra në formë dhuratash si dhe nga ministria.

► Drejtorja e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit

Drejtorja e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit (DEFZH-ja), me qëllim të realizimit sa më efikas të të gjitha kompetencave dhe përgjegjësit, në vitin raportues 2012 ishte e organizuar dhe ka funksionuar me tre (3) sektorë:

1. Sektori i Ekonomisë, Buxhetit dhe Zhvillimit,
2. Sektori i Financave dhe Pagesave, dhe
3. Sektori i tatimit në Pronë dhe të Hyrave

DEFZH-ja, e menaxhuar nga drejtori i drejtorisë dhe me një staf prej (13) zyrtarëve, gjatë tërë vitit raportues kishte një angazhim permanent, me një përkushtim të madhë në drejtim të

realizimit sa më të suksesshëm të të gjitha objektivave dhe detyrave të parashikuara për vitin 2012.

Potencojmë se DEFZH-ja, funksionin e vet e ka ushtruar në bazë të legjislacionit në fuqi i cili rregullon fushëveprimin e saj, të Statutit të komunës, të akteve nënligjore dhe akteve tjera të miratuara në Kuvend të komunës, duke iu përmbajtur prioriteteve dhe objektivave të konceptuara me Planin e punës së DEFZH-së dhe Ekzekutivit komunal, për vitin 2012.

Me qëllimin kryesor që të bëjmë një prezantim sa më gjithëpërfshirës të punëve dhe aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit 2012, në vazhdim me prioritet mbi të gjitha do të veçojmë:

- aktivitetet dhe zhvillimet, në përgatitjen dhe hartimin e dokumenteve strategjike buxhetore dhe zhvillimore të komunës, për vitet 2013-2015,
- raportin për vitin e përfunduar 2011 dhe raportet tremujore për ekzekutimin e buxhetit për vitin fiskal 2012,
- propozim rregulloret dhe vendimet e ndryshme,
- menaxhimin, mbikëqyrjen dhe operimin me mjetet buxhetore sipas buxhetit të aprovuar të komunës, për vitin fiskal 2012, e kështu me radhë.

Do theksuar, se të gjitha këto draft-dokumente të përgatitura nga stafi i DEFZH-së, në kopje fizike dhe në formë elektronike, për procedura të mëtejme gjithmonë me kohë dhe sipas planit të punës iu janë përcjellur: Kryetarit të komunës, anëtarëve të Ekzekutivit dhe organeve të Kuvendit, duke mos lënë pa e përmendur edhe dorëzimet e shumë prej tyre për informim dhe zbatim edhe ministritë e linjës, e në veçanti të Ministrisë së Financave (MF).

Objektivat dhe aktivitetet e realizuara:

- Zhvillimi i proceseve dhe të gjitha aktivitetet shoqëruese në përgatitjen dhe hartimin e draft Buxhetit të Komunës për periudhën afatmesëm 2013 – 2015, me dorëzimin e draftit final në afatin ligjor të organet e Kuvendit, i cili dokument është miratuar më datën 27.09.2012, sipas Vendimit 01-nr.05-400-24297/12 – Për Buxhetin e komunës për vitin fiskal 2013 dhe vlerësimet 2014-2015,
- Qarkorja e Brendshme Buxhetore Komunale nr.01/213– Rishikimi i prioriteteve për Buxhetin komunal 2013-2015, me numër të protokollit: 01-nr.05-16-13075/12, të datës 24.07.2012,
- Qarkorja e Brendshme Buxhetore Komunale nr.02/2013 - Kufijtë buxhetor specifik për drejtoritë dhe përgatitja e dorëzimeve buxhetore të programeve buxhetore funksionale, për vitet 2013-201, me numër 01-nr.05-16-16649/12, të datës 24.07.2012,
- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve Buxhetore të Komunës (KAShK-ja) për vitet 2013-2015, me numër 01-nr.05-16-16739/12. Ky dokument zhvillimor i miratuar në Kuvend më datën 31.07.2012, ka shërbyer edhe si bazë për të gjitha programet buxhetore lidhur me inicimin dhe zhvillimin e të gjitha aktiviteteve buxhetore deri te faza e fundit e nxjerrjes së draft-Buxhetit të komunës për periudhën afatmesëm të viteve 2013-2015,
- Mbajtja e takimeve publike me qytetarët dhe takime tjera që kishin të bëjnë me ekzekutimin e buxhetit për vitin 2011 dhe parashikimet buxhetore për periudhën afatmesme 2013-2015, si
 - ❖ Debatimi me qytetarët për ekzekutimin e buxhetit për vitin 2011, i mbajtur më datën 10.02.2012,
 - ❖ Seancat e veçanta konsultative gjatë muajit korrik 2012, me të gjithë drejtorët – bartësit e programeve buxhetore,

- ❖ Mbjajta e një tryeze të rrumbullakët në mes të anëtarëve të Ekzekutivit komunal dhe anëtarëve të KPF-së, e organizuar më datën 30.08.2012, nga ana e OSBE-së,
- ❖ Organizimi dhe mbajtja e dy (02) dëgjimeve publike me qytetarët e komunës:
 - * Dëgjimi i Parë, më datën 10.07.2012, me temën: “Projeksionet dhe politikat zhvillimore të komunës, të hyrat buxhetore dhe investimet kapitale për vitet 2013-2015”, dhe
 - * Dëgjimi i Dytë, më datën 26.09.2012, ku iu është ofruar publikut të gjërë drafti para miratimit në Kuvend i Buxhetit Afatmesëm i Komunës për vitet 2013-2015, me theks të veçantë viti buxhetor 2013. Duhet theksuar se në këto dy (2) dëgjime publike të sivjetme, organizimi ishte shumë më mirë dhe kemi pasur pjesëmarrje shumë më të madhe të qytetarëve, në raport me vitet paraprake, falë bashkëpunimit dhe ndihmës së ofruar nga dy (02) partnerët tanë, “LOGOS-i” dhe USAID-DEMI (në përgatitjen e posterëve, bilteneve, fletëpalosjet etj.) si dhe nuk duhet anashkaluar edhe kontributin e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL-së),
- Raporti Vjetor Financiar – Për vitin e përfunduar më 31. dhjetor 2011, i hartuar në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit publik (SNKSP), i cili raport njëkohësisht ka shërbyer si dokumentacion bazë për kryerjen e auditimit të rregullt për vitin 2011, nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP-i), përkatësisht nga kompania audituese “KPMG – Albania”,
- Përgatitja dhe hartimi i Raporteve tremujore për ekzekutimin e buxhetit për periudhat: Janar - Mars 2012, Janar – Qershor 2012 dhe Janar - Shtator 2012,
- Propozim/Vendimi me Pasqyrat e tabelave të përgatitur 01-nr.05-400-1413/12. - Për bartjen e Bilanceve të pashpenzuara nga të hyrat vetjake komunale të vitit 2011-2010, në Buxhetin e komunës për vitin 2012, në shumë prej 120.322,93 €, e datës 31.01.2012,
- Propozim-Vendimi me Pasqyrat e tabelave analitike 01-nr.16-11525/12 – Për Rishikimin e Buxhetit të komunës për vitin 2012, i miratuar në Kuvend më datën 31.05.2012,
- Propozim-Vendimi me Pasqyrat e tabelave analitike 01-400-24293/12 - Për ndryshimin e shumave të ndara për projektet kapitale sipas ndarjeve me buxhetin e komunës për vitin 2012,
- Zbatimin e Vendimit nr.04/11 të Qeverisë së Republikës së Kosovës – Për ndarjen e mjeteve shtesë nga Granti Qeveritar në shumë prej 200,000 € (më datën 19.11.2012 kemi marrë konfirmimin me shkrim, ndërsa më datën 20.11.2012, kemi bërë kërkesën për aprovim për ndarjen e këtyre mjeteve sipas programeve buxhetore dhe sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve – KESH, ndërsa me të gjitha detajet janë informuar organet e Kuvendit në takimet e mbajtura gjatë muajit dhjetor 2012),
- Plani i Veprimit 01-nr.16-27781/12 - Për eliminimin e të gjeturave dhe realizimin e rekomandimeve të dhëna me Raportit përfundimtar nga auditimi i vitit 2011, i realizuar nga Zyra e Auditorit Gjeneral (ZAGJ-i) – nga kompania profesionale për auditim “KPMG-Albania”, e shqyrtuar në Kuvend së bashku me draft Raportin e auditimit 2012, më datën 31.10.2012,
- Rregullorja 01-nr.05-400-23798/12 - Për vendosjen e Tatimit në Pronë në territorin e komunës së Kaçanikut, për vitin 2012, e datës 27.09.2012,
- Rregullorja 01-nr.16-27192/12 - Për caktimin e kriterëve për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve, e datës 31.10.2012,

- Vendimi 01-nr.16-31150/12 – Për ndarjen e bursave të studentëve të komunës së Kaçanikut për vitin akademik 2012/2013,
- Vendimi 01-nr.05-400-27763/12 - Për shumën maksimale të arkëtimit të të hyrave nëpër trezorët e arkës, me aplikim duke filluar nga data 01.11.2012 dhe ku është përcaktuar limiti deri në lartësi prej 10.- €,
- (3) vendimet e datës 17.12.2012 - Për regjistrimet e fundvitit: 1/. Vendimi 01-nr.16-31573/12 – Për pasuri kapitale, 2/. Vendimi 01-nr.16-31574/12 – Për inventarizimin e pasurisë, dhe 3/. Vendimi 01-nr.16-31575/12. – Për regjistrimin dhe barazimin e kontos bankare, të arkës dhe depos.
- Raporti i Komisionit sipas Vendimit 01-nr.400-10062/12. – Për barazimin e pagesave të subvencioneve dhe transfereve nga Buxheti i komunës për KF “Lepenci”, për periudhën e viteve 2008-2012, me të cilin raport janë informuar edhe këshilltarët komunal,

Rezultat e arritura në përmbushjen e objektivave financiare brenda DEFZH-së gjatë vitit 2012:

Nga aspekti i inkasimit të të hyrave buxhetore për vitin 2012, DEFZH-ja e ka përmbushur objektivin e planifikuar buxhetor për 86,5% , nga se nga plani vjetor i të hyrave buxhetore për vitin 2012 prej 266,300 €, ka arritur që të inkasojë shumën prej 230,360 €, duke kontribuar drejtpërdrejt në totalin e të hyrave të gjithmbarshme në nivel të komunës për 54,04% (shuma e realizuar e të hyrave vetjake komunale në nivel të komunës ishin në lartësi prej 426,267 €).

Pasqyra tabelare e realizimit të të hyrave sipas llojit, brenda drejtorisë në vitin 2012:

Kodi	P e r s h k r i m i	Planifikimi 2012	Realizimi 2012	Indeksi Realiz./Plan.
40110	Tatimi në Pronë	180,000	151,939	84,4
50001	Taksa për regjistrimin e automjeteve	42,000	37,780	90,0
50019	Taksat tjera administrative	2,000	2,796	139,8
50029	Taksat nga ushtrimi veprimt.biznesit	38,800	35,025	90,3
50104	Gjobat nga Inspektorati	1,000	700	70,0
50205	Pranimi teknik i lokaleve afariste	2,500	2,120	84,8
Gjithësejt :		266,300	230,360	86,5

Në **sektorin e zhvillimit**, kemi mbajtur kontaktet e bashkëpunimit dhe partneritet me të gjithë donatorët dhe me ministrinë e nivelit qendror, me të cilat komuna kishte të nënshkuara marrëveshjet, përkatësisht memorandumet e mirëkuptimit, duke filluar nga:

1. USAID-i,

Në këtë vit në suaza të Marrëveshjes së Mirëkuptimit të nënshkruar nga muaji dhjetor 2010, në vitin 2012 janë realizuar këto projekte:

- Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI), e që në kuadër të këtij projekti kemi realizuar programit për ngritjen e performancës në shërbimet e Administratës Komunale me funksionimin e ekipit të formuar i ashtuquajtur EPOK-u, në dy (2) projekte: 1/. Pjesëmarrja më e madhe e

- qytetarëve në vendim-marrje (hartimi i rregullores komunale për transparencë dhe aktivitetet në organizimin e suksesshme të dëgjimeve buxhetore ku rezultatet kulmuan me rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në aktivitetet e buxhetimit nga 236 në vitin 2011, në 284 pjesëmarrës të regjistruar në vitin 2012), dhe 2/. Mbrojtja e ambientit (hapësirat gjelbëruese, pastrimi i ambientit dhe vendosja e shportave),
- Financimi i fushatës nacionale për ngritjen e vetëdijes për pagesën e Tatimit në Pronë, e cila është zgjeruar në nivelin komunal përmes shpërndarjes në teren të 100 posterave, 800 fletëpalosje, 10 billborde, si dhe audio dhe video reklama të publikuar në TV-të e vendit,
 - Ndihma e ofruar në krijimin e bazës së të dhënave elektronike për pasurinë e paluajtshme të komunës, si bazë për gjenerimin e të hyrave komunale (regjistrimi i pronës dhe aseteve të komunës),
 - Projekti: "Ndërtimi i Parkut Rinor të Shtëpia e Kulturës "Xh.Kurtaj" në vlerë prej 45,515 € (USAID/DEMI ka bashkëfinancuar me 35,303 €),
 - Projekti: "Sinjalizimi vertikal dhe horizontal në disa lokacione në komunën e Kaçanikut", në vlerë prej 26,422 € (USAID/DEMI ka bashkëfinancuar me 20,381 €),
 - Furnizimi me pajime teknologjike dhe inventar të Qendrës për Shërbime të Qytetarëve (QSHQ-së) dhe Zyrrave të Vendit, komuna ka financuar në fund të vitit 2012 shumën prej 20,518 €, ndërsa USAID-DEMI ka marrë obligimin kontraktues që pas procedurave të kryera të tenderimit 2012 që të bëjë blerjen e inventarit në fillim të vitit 2013,
 - Furnizimin me pajime teknologjike (laptop dhe projektor) të Zyrës për Barazi Gjinore, ku USAID-DEMI ka financuar me 940 €,
 - Në bashkëpunim me ekspertët e USAID-DEMI, jemi në finalizimin e punëve në hartimin e broshurës së komunës "Investo në komunën e Kaçanikut",

Po ashtu, me projektet e USAID-it jemi në zbatim të Programit për Përmirësimin e Mjedisit Afarist (PPMA). Sipas anketave të bëra në vitin 2011 dhe rezultateve të prezantuara në buletin "Indeksi i Konkurrencës në Komunitet e Kosovës (IKKK-së)", komuna e jonë është e ranguar në pozitën e 9-të, duke u ngritur për 5-së pozita më lartë në listën e 30 komunave të Kosovës (në anketën e muajit shkurt 2010, e publikuar në vitin 2011 ishim të ranguar në vendin e 15-të).

2. PROJEKTI LOGOS-it – Zyra ndërlidhëse e Qeverisë Zvicerane "Intercooperation" - Organizata implementuese " Helvetas Kosova" :

Në thirrjen (fazën) e tretë në vitin 2012, kemi firmosur Marrëveshjet e Mirëkuptimit (MM) për dy (2) projekte:

- **Projekti - 1:** " Ndërtimi i trotuarit në Kaçanik të Vjetër në vlerë të kontraktuar prej 65,619 €, me participim të Logos-t në shumë prej 48,858 €, dhe
- **Projekti – 2:** "Ndërtimi i trotuarit për këmbësor nga SHM "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" deri në fshatin Kovaçec" në shumë të kontraktuar prej 64.949,50 €, ku nga Logos-i kemi financimin prej 45000 €,

3. CARITAS-i Luksemburgut:

- Bashkëpunimi ynë me Qeverinë e Luksemburgut – Caritasin, është filluar nga viti 2009, ndërsa në vitin 2011 pas kontakteve tona dhe takimit të mbajtur më datën 21.06.2011 me të gjithë udhëheqësit e fshatit dhe aplikimit të tyre,

komuna ka arritur nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit në realizimin e projektit: "Zbutja e varfërisë përmes zhvillimit të qëndrueshëm". Përfitues për tri vitet vijuese është komuniteti i fshatit Elezaj, në të cilin lokalitet në tre (03) sektorët e caktuar (arsim, shëndetësi dhe në veprimtaritë për gjenerimin e të ardhurave), do të financohet shuma investive prej 400,343 € (me participim të komunës prej 30% ose 83,883 €), ndërsa për vitin 2012 janë financuar 69,723 € (nga Caritas-i kemi financimin vetëm në shumë prej 19,723 €).

4. CDF – (Commity Development Found) :

- Realizimi i projektit : “ Ndërtimi i Qendrës për komunitete në Kaçanik të Vjetër ”, në vlerë të përgjithshme prej 62,465 € (CDF ka financuar 45,382 €),

5. Projekti i Zhvillimit të Turizmit Rural – Regjioni Lindja.

- Komisioni Evropian ka financuar këtë projekt për (8) komunat e regjionit Lindje, ku përveç komunës sonë dhe Ferizajt, si komunë bartëse e këtij projekti, janë të përfshirë edhe komunat tjera si Hani Elezit, Shtërpca, Vitia, Novo Bërda, Kllokoti dhe Kamenica. Në fazën e parë gjatë vitit 2012 deri te krijimi i guidës turistike, janë zhvilluar një mori aktivitetesh si, përcaktimi i bujtinave, trajnimi i personave për pranimin e mysafirëve, përcaktimi dhe vendosja e shenjave njoftuese turistike sipas hartës turistike të komunës, përshkrimi i pikave të interesit turistik, draft elaborati i projektit, etj.

6. Qeveria Qendrore - Me ministrinë e linjës, gjatë periudhës raportuese 2012 kemi arritur të sigurojmë grante plotëse për realizimin e (3) projekteve, përkatësisht realizimin e dy (2) prej tyre në vitin 2012 dhe (1) i cili do të implemntohet në vitin 2013 :

- **Projekti – 1**, Me Ministrinë e Administratës së Pushtetit Lokal (MAPL-ja), kemi realizuar projektin: “ Ndërtimi i rrugës në Lagjen Shorrë – Zhark, në fshatin Dubravë”, me një kosto totale prej 82,247 € “, ku MAPL-ja ka financuar me 80,000 €,
- **Projekti – 2**, Me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenës Sociale (MPMS), kemi realizuar projektin: “Punësimi sezonal” në pastrimin e ambientit në lokacione të caktuara sipas projektit me stafin e KRM “Pastërtia” dhe të papunësuarit e përzgjedhur nga Zyra Komunale për Punësim, në shumë të përgjithshme prej 45,184 €, e financuar tërësisht nga MPMS-ja, dhe
- **Projekti – 3**, Me Ministrinë e Infrastrukturës (MI-ja), gjatë muajit dhjetor 2012, janë zhvilluar procedurat e tenderimit për projektin: “ Asfaltimi i rrugës Gajre-Ivajë-Shtrazë” dhe pas procedurave të përzgjedhjes së operatorit ekonomik, në vitin 2013 do të zhvillohen punimet.

Në fushën e **auditimit**, në muajin maj 2012, kemi pasur aditimin e rregullt vjetor në menaxhimin dhe operimin me mjetet buxhetore të komunës për vitin 2011, nga kompania audituese Sh.P.K. “KPMG - Albania”, e përzgjedhur nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP-i). Pas pranimit të Raportit përfundimtar me rekomandimet e dhëna më datën 29.07.2012, i njëjti është publikuar menjëherë në ueb-faqen e komunës dhe në seancën 9-të të Kuvendit janë informuar edhe këshilltarët komunal. Po ashtu, në këtë seancë këshilltarëve komunal iu është dorëzuar edhe Plani i Veprimit për eliminimin e të gjeturave dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga kompania audituese. Njëkohësisht, kur jemi këtu duhet përmendur edhe funksionimin

e Komitetit të Auditimit të Brendshëm (KAB), i cili komitet gjatë vitit 2012 ka mbajtur dy (2) takime, të parën më datën 28.02.2012 dhe takimi i dytë më datën 30.10.2012.

Në kuadër të bashkëpunimit me **Bizneset lokale** duhet përmendim zbatimin e Vendimit të KK-së 01-nr.16-3002/12 – Për lirimin e bizneseve nga taksa komunale – ngarkesa vjetore për tri (3) vite 2012-2014, pastaj mbajtja e dy (2) takimeve nën sponsorimin e USAID/PPMA, funksionimin e Qendrës Komunale të Regjistrimit të Bizneseve (QKRB), etj.

Në Qendrën Komunale për Regjistrim të Bizneseve (QKRB), e cila qendër ka filluar së funksionuar nga 02.06.2011, në periudhën e vitit raportues 2012 i ka zgjedhur 123 aplikacione prej tyre: 49 biznese të reja, 14 ndryshime në biznes dhe 60 aplikacione për marrje të certifikatave me logo të re. Po ashtu, nga zyrtari i biznesit janë lëshuar edhe 95 certifikata të ndryshme sipas kërkesave të parashtruar, të cilat kryesisht kanë të bëjnë për pjesëmarrjen e bizneseve në tendere, si dhe sipas kërkesës së Ministrisë së Diasporës (MD-së) kemi autorizuar Zyrtarin e Bizneseve për grumbullimin e të dhënave për bizneset që veprojnë në komunë që janë në partneritet me bizneset nga diaspora, ku nga i njëjti zyrtar është përpiluar lista e bizneseve të tilla dhe iu është dërguar kësaj ministrie, por që për fat të keq ky numër është simbolik në komunën tonë, etj.

Inspektori i Tregut dhe i të Hyrave, duke i ushtruar kompetencat e tija gjatë vitit 2012 ka bërë 68 pranime teknike të lokaleve afariste, ka lëshuar 98 urdhëresa me shkrim, 7 aktvendime për eliminimin e parregullsive të konstatuara te bizneset komunale, 624 vërejtje për pagesë të ngarkesës vjetore nga biznesit sipas faturimit deri në vitin 2011, 69 procese që kanë të bëjnë me vendosjen e mbishkrimeve të firmës dhe orarit të punës, kontrollimi i të gjitha furrave të bukës lidhur me peshën e bukës (aksione të përbashkëta me inspektorin sanitar); 1 aktvendim për mbyllje të përkohshme të lokalit afariste, konfiskimin e përkohshëm të katër (4) aparateve të lojërave të fatit sipas Vendimit komunal 01-nr.05-16-883/28.02.2011 - Për ndalimin e organizimit të disa lojërave të fatit në territorin e komunës së Kaçanikut dhe pesë (5) gjoba me aktvendime në shumë totale prej 700,00 €.

Zyra e Tatimit në Pronë (ZTP), duke iu përmbajtur Planit operativ të punës, që nga muaji janar ka filluar me përgatitjet teknike dhe organizative të procesit të shpërndarjes së faturave të Tatimit në Pronë për vitin 2012. Të ndihmuar edhe nga zyrtarët e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, është arritur që me sukses të realizojmë procesin e shpërndarjes së faturave në teren (është një vlerësim edhe nga tatimpaguesit se nga komuna kemi një shpërndarje shumë më të mirë në dy vitet e fundit 2011-2012, se sa në vitet 2008-2010, kur ky shërbim përmes asistimit nga MF-ja, ishte i kontraktuar me PTK-në). Për vitin raportues janë printuar dhe shpërndarë gjithsej 8,471 fatura në shumë totale prej 228.056,90 €.

Sipas dispozitave ligjore, pas pranimi të faturave të Tatimit në Pronë, në afatin ligjor Bordit Komunal i Ankesave (BKA-së), iu janë adresuar 98 ankesa nga tatimpaguesit komunal, nga të cilat 86 janë miratuar në favor të palës, kurse 12 janë refuzuar, si të pa baza.

Në sferën e rifreskimit të të dhënave bazë në soutuer, gjatë vitit janë rianketuar dhe regjistruar 194 prona të reja..

Në inkasimin e të hyrave nga ky lloj i tatimit komunal, në fund të viti sipas gjendjes 31.12.2012, është arritur realizimi i pagesave në shumë totale prej 151.938,72 € duke u përmbushur objektivin e planifikuar vjetor për 102,1% ose për 2,1% mbi plan ose shprehur në masë monetare një shumë prej 3.068,77 € (në vitin 2011 kemi pasur një grumbullim prej 148.869,95 €). Kur jemi te grumbullimi i të hyrave nga Tatimi në Pronë, potencojmë edhe këtë të dhënë, se përfundimisht për periudhën e viteve 2002-2012, kemi arritur në inkasimin shumë prej

1,267,276 €, të cilat mjete në mënyrë strikte janë destinuar vetëm për realizimin e projekteve kapitale.

Në vitin 2012, Agjencionit të Kosovës për Privatizim (AKP-së), i kemi dorëzuar faturat e papaguara për pesë (5) subjekte të privatizuar ose të cilat janë në proces të privatizimit (likuidimit) që janë debitorë të komunës në lartësi prej 264.524,83 €, dhe ate:

- 1) Fabrika e “Silcaporit”, në shumë prej 18.618,47 €,
- 2) FGG “Lepenci”, në shumë prej 6.614,65 €,
- 3) NSHT – Tregtia “Sharr”, në shumë prej 31.211,64 €,
- 4) KB “Ramadan Agushi”, në shumë prej 3.044,46 €, dhe
- 5) “Bankosi” – Njësia në Kaçanik, në shumë prej 5.035,26 €

Në sferën e **Buxhetit dhe Financave**, i gjithë stafi është angazhuar në përmbushjen me kohë dhe në cilësi profesionale të të gjitha punëve dhe detyrave, përmbajta me saktësi e afateve të përcaktuara kohore rreth zhvillimit të aktiviteteve në përgatitjen e draft – Buxhetit të komunës për vitin 2013 dhe buxhetimin afatmesëm 2013-2015, në përgatitjen e Planit të rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2012 dhe përshtatjeve të ndryshimeve të miratuara me Rishikim të buxhetit, në rregullimin e ndarjeve buxhetore, raportimi mujor i faturave të papaguara në Thesar për çdo muaj deri më datën 15-të sipas Rregullës 4, në regjistrimi i inventarit dhe pajimeve në sistemin unik në nivel të vendit i quajtur Sistemi e-qeverisja, trajnimi dhe aftësimi i zyrtarëve financiar alternativ, etj.

Në periudhën raportues 2012, nga të gjitha programet dhe nënprogramet buxhetore sipas kërkesave të parashtruara janë iniciuar procedurat duke u bërë zotimi i mjeteve në 1,627 urdhër zotimi për pagesa (UZP), pastaj është vazhduar me procedimin e tyre në formë të shpenzimeve dhe aprovimi i të gjitha shpenzimeve për të gjitha kërkesat e parashtruar dhe vendimet e marrura për shpenzime, prej të cilave përfundimisht me gjendjen e fundvitit 31.12.2012, janë ekzekutuar në total shuma e shpenzimeve prej 1,708,562 € (papërfshirjen e Pagave dhe Mëditjeve të cilat menaxhohen dhe mbikëqyren nga MF-ja dhe MAP-i, të cilat janë në masë prej 3,728,231 €).

Me Ministrinë e Financave – Departamenti Thesarit, për çdo tremujor sipas ligjit janë bërë barazime të regjistrimeve në mes të komunës dhe të dhënave të përpunuara në Sistemin e Informatave të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK-ja);

Arkëtimi i drejtpërdrejtë ditor i të gjitha pagesave në të gatshme në arkën kryesore të Administratës Komunale dhe regjistrimi i tyre, i cili për periudhën raportuese ishte në masë monetare prej 59.260,65 € (nga arka e Administratës komunale kemi arkëtimin në shumë prej 31.962,50 €, nga Zyrat e Vendit shuma prej 11.857,00 €, nga taksat pyjore të Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – DBPZh shuma prej 1.430,00 € dhe nga Shëndetësia kemi shumën prej 14.011,15 €);

Barazimi çdo ditorë i pagesave të realizuara nga trezori i arkës dhe përmes bankave komerciale, ku nga të hyrat vetjake komunale – pranimet direkte të depozituara në konton e buxhetit të komunës kemi gjithsej 248 raporte bankare në total prej 363,813 € dhe transferet e realizuara nga të hyrat indirekte shumën prej 62,454 € ose gjithsej pranimet në total prej 426,267 €.

Lidhur me detajet e tjera rreth menaxhimit dhe ekzekutimit të mjeteve buxhetore gjatë vitit 2012 në nivel të Organizatës buxhetore të komunës, DEFZH-ja ka përgatit Raportin Vjetor Financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012, për të cilin veçmas do të debatohet në organet e Kuvendit të Komunës, gjatë seancës së 3-të e parashikuar për muajin mars 2013.

► **Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit**

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit është e organizuar në dy sektorë:

Spektori i Urbanizmit, Planifikimit Hapësinor dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Spektori i Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë.

Duke u bazuar në planin e punës së Drejtorisë dhe në dispozitat ligjore në fuqi, janë kryer të gjitha punët zyrtare, me një angazhim maksimal.

Në raportin vijues janë të përfshira të gjitha kërkesat dhe shkresat e kësaj Drejtorie sipas sektorëve.

Spektori i Urbanizmit, Planifikimit hapësinor dhe Mbrojtjes Mjedisit:

Në sektorin e Urbanizmit, Planifikimit Hapësinor dhe Mbrojtjes së Mjedisit në periudhën prej 01.01.2012 deri më 31.12.2012, nga Zyra e Pritjes në këtë sektor janë përcjellur gjithsej 708 lëndë të ndryshme. Në këtë numër të lëndëve hyjnë kërkesat e parashtruara nga palët e ndryshme drejtuar kësaj Drejtorie dhe shkresa të ndryshme të Drejtorisë drejtuar palëve dhe Drejtorive komunale dhe institucioneve të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me punën e Drejtorisë.

Llojin e kërkesave të parashtruara nga palët në periudhën janar-dhjetor të vitit 2012 e paraqesim si vijon më poshtë:

- 2 shkresa me Auditimin e Brendshëm (kërkesa për marrjen e lëndëve dhe vlerësimi)
- 70 shkresa me Zyrën e Prokurimit (përcjellja e paramasave si dhe njoftimi me ecurinë e punimeve)
- 21 kërkesa dhe ankesa nga komunitetet e fshatrave dhe lagjeve të ndryshme
- 67 kërkesa për leje ndërtimi ku 21 janë të aprovuara
- 4 shkresa për MAPL-në
- 7 kërkesa për ndarje trualli
- 2 kërkesa për rrënim të objekteve
- 25 kërkesa të ndryshme nga persona fizik (qytetarët e komunës së Kaçanikut)
- 20 shkresa –vendime të Kuvendit
- 8 shkresa-vendime të Kryetarit të Komunës
- 18 kërkesa nga studentët për vërtetim të largësisë Kaçanik-Prishtinë
- 3 shkresa për MMPH-në
- 1 kërkesë për USAID-DEMI
- 9 kërkesa për ndarje fizike
- 3 ankesa të ndryshme në sektorin e Mbrojtjes së Mjedisit
- 2 njoftime të ndryshme në sektorin e Mbrojtjes së Mjedisit
- 24 kërkesa të ndryshme në sektorin e Mbrojtjes së Mjedisit
- 4 raporte të Komisionit në sektorin e Mbrojtjes së Mjedisit
- 4 pëlqime të ndryshme në sektorin e Mbrojtjes së Mjedisit

Gjatë periudhës janar-dhjetor, detyrat e veta zyrtare i ka kryer edhe Inspektori Mjedisor, të cilat kanë të bëjnë me çështjen e mbrojtjes së mjedisit, si ndalimi i hedhjes së mbeturinave, pengimi i ndotjes së lumenjve, ndalimi i eksploatimit të rërës në mënyrë ilegale nëpër shtretërit e lumenjve, kontrollimi i eksploatuesve të gurit dhe i gurthyeseve lidhur me veprimtarinë e tyre në harmoni me ambientin e pastër, si dhe angazhimi i tij për sensibilizimin e qytetarëve të Komunës sonë lidhur me problemin e ndotjes së mjedisit, aktivitet ky i zhvilluar me ndihmën e grupit ambientalistëve të rinj. Në këtë drejtim me grupin e ambientalistëve të rinj është bërë shpërndarja e broshurave për ndalim të hedhjes së mbeturinave në mënyrë ilegale, janë zhvilluar dy aksione

për pastrimin e hapësirave publike prej mbeturinave, është mbajtur Java e Mjedisit, në muajin qershor, ku janë zhvilluar aktivitete të ndryshme lidhur me çështjen mjedisore, aksione për pastrimin e hapësirave publike dhe mbrojtjen e ambientit.

Pjesëmarrës i përhershëm në komisionin për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore dhe shfrytëzim të resurseve natyrore.

Pjesëmarrës në Hartimin e Planit Rregullues dhe komisione të tjera.

Janë pranuar 38 lëndë në sektorin e Mjedisit: (vetëm një është transferuar për vitin tjetër)

15 Kërkesa për Pëlqime për hulumtim dhe eksploatim të gurit, shfrytëzim të ujit, 1 kërkesë për hidrocentral për prodhimin e energjisë elektrike në lumin Lepec

Gjatë këtij viti janë lëshuar 8 pëlqime, 4 aktvendime për refuzim të kërkesës së palës,3

aktvendime për miratim të kërkesës.

Në vitin 2012, në këtë sektor detyrat e veta zyrtare i ka kryer edhe Inspektori i Ndërtimtarisë, të cilat kanë të bëjnë me ndërprerjen e ndërtimeve pa leje në territorin e Komunës së Kaçanikut. Në kuadër të kësaj nga Inspektori i Ndërtimtarisë në vendin e ngjarjes janë bërë 17 Procesverbale, 12 Urdhëresa për ndalim të punimeve deri në pajisjen me Leje Ndërtimi, masa të cilat kanë rezultuar pozitivisht meqenëse palët i janë nënshtruar procedurave të rregullta ligjore dhe pas kompletimit të dokumentacionit janë pajis me Leje Ndërtimi. Duhet cekur se gjatë kësaj periudhe ka kryer edhe punë të tjera me urdhër të Drejtorit të Drejtorisë, si dhe në komisione të ndryshme në pranimin e punëve.

Zyra për tokë ndërtimore në kuadër të kësaj Drejtorie gjatë këtij viti ka zhvilluar aktivitetet e tij zyrtare konform dispozitave ligjore në fuqi që kanë të bëjnë me mbledhjen e taksave komunale nga qiraja për shfrytëzim të përkohshëm të pronës komunale. Gjatë kësaj periudhe ky zyrtar ka bërë:

- 115 kontrata janë hartuar për shfrytëzim të tokës ndërtimore
- 91 inkasime
- 6 mbyllje të përkohshme
- 1 kërkesë për asistim të policisë
- 5 kërkesa për prova nga Avokatja Komunale
- 63 procesverbale si dhe 147 biseda gojore mbi pagesën e qerasë ndërtimore dhe lokaleve
- 3 kërkesa për ndërprerjen e shfrytëzimit të lokalit si dhe 3 aktvendime për këto
- 16 urdhëresa shfrytëzuesve të tokës ndërtimore për pagesë
- 45 ftesa për vazhdimin e kontratave
- 1 vërtetim për rrënimin e lokalit
- 68 njoftime për lirim të objekteve të përkohshme sipas kontratës

Gjatë këtij viti kemi punuar edhe në komisionin e formuar nga Kryetari i Komunës dhe Drejtori i Financave për mbledhjen e taksave dhe tatimeve komunale

Gjatë këtij viti kemi bërë edhe njoftimin përmes Radio Kaçanikut, pronarët e lokaleve afariste të ndërtuara në pronën komunale të cilët nuk i kanë kryer obligimet ndaj Kuvendit Komunal.

Në periudhën e lartpërmendur, zyrtarët e Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, përveç angazhimit të tyre në shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave të palëve, kërkesat e drejtuara nga kjo Drejtori, Drejtorive komunale dhe institucioneve tjera shtetërore etj, angazhim të madh kanë dhënë edhe në realizimin e projekteve komunale, si në:

- punimin e Paramasave dhe Parallogarive për projektet e ndryshme, investues i të cilave është Komuna e Kaçanikut,
- mbikëqyrjen aktive të projekteve gjatë implementimit të tyre,

- angazhim maksimal në procesin e hartimit të PRRU për zonën e I-rë urbanistike për qytetin e Kaçanikut,
- angazhim maksimal në procesin e hartimit të Planeve Rregulluese Zona Turistike – Malet e Sharrit

Mbikëqyrje e projekteve të realizuara në bashkëfinancim me LOGOS-in (trotuari i Kaçanikut të Vjetër si dhe trotuarit në rrugën “V.Çaka”)

Pjesëmarrje aktive në Forumin Lokal për Trashëgimi Kulturore FLTK

Bashkëpunim të ngushtë Caritas-in e Luxemburgut në projektet e fshatit Elezaj

Gjatë këtij viti nga ky sektor duke u bazuar në Vendimin komunal për tarifa e

ngarkesa tjera administrative janë realizuar të hyra komunale si vijon:

Nga Lejet e Ndërtimit janë realizuar të hyra në vlerë: **11979.94 €**,

Nga qiraja për shfrytëzim të pronës komunale janë realizuar të hyra në vlerë: **15161.54 €**,

Vërtetimet e ndryshme janë realizuar të hyra në vlerë: **15 €**,

Nga sektori i Mjedisit: **880 €**,

Pëlqimet për rrënim: **20 €**, që në total arrin shumën **28056.48 €**.

Gjatë vitit 2012, kjo Drejtori ka has në disa vështirësi që kanë të bëjnë me vendosjen e disa kërkesave të palëve sidomos ato të Lejeve të Ndërtimit, për shkak të kompletimit të këtyre kërkesave me dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e saj si p.sh. marrja e Pëlqimeve nga disa organe kompetente si KEK-u – marrja e Pëlqimeve për kyçje në rrjetin elektrik, marrja e Pëlqimeve nga MBPZHR në Prishtinë- për ndërrim destinimi të tokës bujqësore (klasat 1-4), marrja e Pëlqimeve për kyçje në rrugët regjionale dhe ato magjistrale, mos miratimi i Ligjit të legalizimit të objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimi, etj.

Të hyrat e përgjithshme të realizuara nga ky sektor për vitin 2012, bazuar Vendimin komunal për tarifa dhe ngarkesa tjera komunale janë: **28056.48 €**

Sektori i Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë,

Gjatë vitit paraprak janë regjistruar 4222 lëndë, ku nga ky numër janë zgjedhur 99.98 % e tyre. Nuk janë zgjidhur 09 lëndë apo 0.02 % e tyre, për shkak të mos interesimit të palëve që të çojnë procedurën e përfundimit të lëndëve deri në fund.

Në fushën e Kadastrit janë evidentuar 4222 kërkesa që kanë të bëjnë me lëshimin e dokumenteve zyrtare, regjistrimin e pronës së paluajtshme, hipotekave, ndarjeve fizike etj.

Dokumentet e lëshuara: 3855 lëndë:

- Fleta poseduese, 1168 lëndë
- Kopje të planit, 552 lëndë
- Certifikata të gjendjes së pasurisë, 1642 lëndë
- Kërkesa për ndarje fizike, 66 lëndë
- Koordinata gjeodezike, 361 lëndë
- Identifikime, 2 lëndë
- Të ndryshme, (Pronësia, AKM, KFOR, K. Kaçanik etj.), 64 lëndë

Regjistri i RDPP-së 367 lëndë:

- Kërkesa për bartjen e pronës, 226 lëndë
- Ndarje fizike e Parcelave, 92 lëndë
- Regjistrimi i Hipotekave, 30 lëndë
- Qirambajtje 99-vite, 8 lëndë
- Të ndryshme, 11 lëndë

Ky sektor ka vazhduar me përpikëri të bëjë implementimin e ligjit mbi themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së paluajtshme Nr. 2002/5 dhe plotësimin e tij Nr.2003/13, si dhe ligjit mbi hipotekat Nr.2004/4.

Regjistrimi i lëndëve bëhet kryesisht në programin zyrtar të RDPP-së, me të cilin jemi të lidhur direkt me rrjetin qeveritar në Agjencionin Kadastral të Kosovës.

Në fushën e Kadastrit nga 01.01.2012 deri 31.12.2012 ka realizuar të hyra buxhetore në shumë prej: 16.641,00 € apo 97.88 %

- Fletët Poseduese dhe Kopjet e Planit, 5.599,00 € nga 7.000,00 apo 79.98 %

- RDPP dhe Hipotekat , 11,04200 € nga 10.000,00 € apo 110.42 %

TOTALI: **16.641,00 €** nga 17.000,00 € apo 97.88 %

Në fushën e Gjeodezisë janë regjistruar gjithsej 66 lëndë që kanë të bëjnë me Ndarje Fizike, Ndërrim të kulturës, Rilevim gjeodezik të terrenit, etj.

Nga këto 10 kërkesa janë kryer nga ana e zyrtarëve të Komunës ndërsa pjesa tjetër e kërkesave nga ana e Gjeodetëve dhe Kompanive Gjeodete të Licencuara nga Agjencioni Kadastral i Kosovës, me të cilët sektori i kadastrit ka bashkëpunim mjaft të mire dhe profesional.

Nga këto janë përfunduar gjithsejtë 57 lëndë, kurse në procedurë të zgjidhjes së tyre janë edhe 9 lëndë për shkak që për momentin palët nuk kanë shprehë interesimin e tyre për vazhdimin e procedurave të mëtutjeshme.

Për lëndët e bartura nga viti i kaluar varësisht kur pala shpreh interesim për kryerjen e tyre ajo mund të merret parasysh.

Gjatë këtij viti ky sektor gjithashtu ka punuar edhe në lëndët e kadastrit siq janë: Kopjet e Planit, Koordinatat gjeodezike, Identifikimet etj.

Është vazhduar me Implementimin e Kadastrit digjital, ku është punuar në barazimin e pjesës grafike të Operativit Kadastral me atë tekstual.

Është vazhduar me bashkëpunim me Agjencionin Kadastral të Kosovës në eliminimin e gjitha problemeve që kanë dalë gjatë punës së përditshme profesionale në këtë sektor, gjithashtu ky bashkëpunim është bërë edhe sa i përket trajnimit të mëtutjeshëm të personelit që është i angazhuar në kuadër të këtij sektori.

Ky sektor nga 01.01.2012 deri 31.12.2012 ka realizuar të hyra buxhetore në shumë prej: **11,742.00 €** apo **97.85 %** nga 12,000.00 € të planifikuara.

Sa i përket Sektorit të pronësisë, puna është kryer duke u bazuar nga dispozitat ligjore në fuqi, Ligjin e Procedurës Administrative dhe Ligji mbi Uzurpimet Arbitrare.

Janë kryer kryesisht lëndë që kanë të bëjnë me rregullimin e marrëdhënieve pronësore-juridike, qarkullimi i pasurisë së paluajtshme, uzurpimi arbitrar i tokave si dhe kontestet pronësoro-juridike.

Gjithashtu një angazhim i vazhdueshëm i këtij sektori në bashkëpunim të ngushtë edhe me sektorët tjerë të Drejtorisë e më gjerë ka qenë përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për AKP-në lidhur me rregullimin e çështjeve të ndryshme pronësoro-juridike.

Krahas këtyre punëve brenda këtij organi, janë koordinuar punët me sektorë tjerë të organeve komunale dhe trupat tjera punuese duke hartuar dhe ofruar informata detale lidhur me çështje të caktuara pronësoro-juridike.

Gjatë vitit paraprak kemi pasur këto aktivitete në Sektorin e Pronësisë ku:

- 9 propozim vendime për Kuvend

- 6 Aktvendime për uzurpime ku procedura është hedhur poshtë,
- 1 Marrëveshje lidhur me vendosjen e trafos elektrike në lagjen “Dushkaja” në Kaçanik,
- Kontratë lidhur mbi themelimin e servitutit me kompaninë “MATKOS - Group” si dhe Raporte dhe Informata për AKP-në.

Është punuar në hartimin e listës së pronës së Komunës dhe hulumtimi i dokumentacionit të nevojshëm në mënyrë që të mbahet një evidencë e saktë e pronës Komunale.

Rregullimi i marrëdhënieve pronësore-juridike paraqet një sfidë të veçantë rreth disa çështjeve që kanë të bëjnë me pronën Komunale dhe atë: rregullimi i pronës që ka të bëjë me institucionet arsimore, shëndetësore, rrugët publike e që janë në interes publik.

Vlen për të përmendur edhe hartimi i draft rregullores për dhënien e banesave në shfrytëzim me qira, përcjellja e ligjeve të Republikës së Kosovës, dhënia dhe përgatitja e informatave të ndryshme si dhe ndihma konkrete e Zyrës Komunale Kadastrale.

Vlen të theksohet se nga taksa paguesit si të hyra në këtë sektor këtë vit në bazë të raporteve tona, janë inkasuar gjithsejtë: **28.383,00 € apo 97.87 %** e shprehur në përqindje që plani vjetor është realizuar nga buxheti i paraparë prej 29.000,00 €.

► Drejtoria Shërbimeve Publike dhe Emergjencës

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, fushë veprimtarin e sajë, edhe këtë vit e ka organizuar për mes dy sektorëve :

- Sektorit të Shërbimeve Publike dhe
- Sektorit të Emergjencës(mbrojtja dhe shpëtimi)

• Sektori i Shërbimeve Publike

Transporti publik i udhëtarëve. Edhe këtë vit, sipas planit vjetor në fillimin të Janarit, kemi bërë shpalljen publike për rregullimin transportit publik të udhëtarëve në komunën tonë. Pas pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave, për vija të rregullta me rend të udhëtimit kemi lëshuar: 10 Leje Pune për kryerjen e transportit publik të udhëtarëve me autobus, 6 Leje Pune për kryerjen e transportit publik me kombi, dhe 34 Leje Pune për kryerjen transportit publik me Auto-taksi. Ndërkaq, në mbështetje të Ligjit për Transportin Rrugor 2004/1, janë refuzuar dy kërkesa për kombi-taksi , një me Autobus, dhe për auto-taxi (4+1), një është refuzuar dhe dy janë pezulluar. Pas legalizimit të vijave të transportit publik të udhëtarëve , në vazhdimësi kemi bërë inspektimet e këtyre vijave të rregullta, dhe të atyre që nuk posedojnë Leje Pune. Plane Operative në bashkëpunim me Policin e Kosovës, janë realizuar në këto periudha: prej 05.07.2012, deri më 28.07.2012, dhe prej 17.09.2012 deri më 05.10.2012.

Vendosja e shenjave horizontale dhe vertikal në komunikacionin rrugor. Edhe gjatë këtij viti, jemi kujdesur për ta përmirësuar infrastrukturën rrugore, përkatësisht në vendosjen e shenjave vertikale dhe horizontale në komunikacion. Në kuadër të kësaj kemi hartuar;”Planin e Veprimit për Përmasimin e Shërbimeve”, së bashku me USAD-in, ku fillimisht janë mbajtur disa punëtori për hartimin këtij projekti dhe pastaj edhe është realizuar ky projekt. Për realizimin e këtij projekti 80% e mjeteve janë donacion nga USAID, dhe 20% nga komuna Me këtë projekt janë vendosur: 20 shenja; kufizim shpejtësie 30 km/h, 2 shenja; kufizim shpejtësie 40 km/h, 8 kryqe të andreut me një palë binar, 12 shenja; stop, 6 shenja; kryqëzim në rrugë me përparësi kalimi, 8 shenja; vendkalimi për këmbësor (vertikalisht), 2 shenja; parking, 20 shenja; afërsi e fëmijëve në rrugë, 20 shenja; fëmijët në rrugë, 2 shenja; kryqëzim në rrugë dytësore në kënd të drejte, 24 shenja; vendndalim për autobus, 1 shenjë; orientuese, 7 shenja;emërtim institucionit, 4 shenja;emërtim i lumenjve, 15 shenja emërtim i vendbanimeve, 148 shenja; emërtim i rrugëve,

vendkalime për këmbësor me sipërfaqe 229.5 m², 3.7 km vijë gjatësore në mes të rrugës, dhe atë 2.7 km në rrugën Tushaj-Dallosh, dhe 1 km në qytet, 34.55 m² sipërfaqe e ngjyrosur e vijës Stop para vend kalimi të këmbësoreve, dhe 31 shigjeta të ngjyrosura orientuese horizontale(për shkak të kushteve atmosferike ky projekt nuk është përfunduar ende).

• **Mirëmbajtja e infrastrukturës.**

Ujësjellësi dhe kanalizimi. Rrjeti i ujësjellësi kryesor që furnizohet qendra komunale, mirëmbahet nga N.K.P.”Lypeteni”, dhe njëkohësisht bëhet edhe klorizimi në mënyrë automatike. Në Shtator të këtij viti, edhe për kundër vështirësive që kemi pasur, kemi arritur ta bëjmë funksional edhe rrjetin K. i Vjetër-Begracë, duke i eliminuar defektet e rrymës te pompat e ujit dhe defektet tjera të shkaktuara në rrjet. Edhe ky rrjet është futur nën përkujdesjen e N.K.P “Lypeteni”, ndërsa vetëm rrjeti në fshatin Stagovë , mirëmbahet nga një operator privat.

Po ashtu, edhe rrjeti i kanalizimit fekale mirëmbahet nga kjo kompani komunale publike. Duhet theksuar se drejtoria ka realizuar disa projekte të vogla për sanimin e kanalizimit në qendrën komunale, siç janë: sanimi i kanalizimit në rr.”V.Çaka”,te ndërtesa për ballë stacioni të autobusëve, sanimi i kanalizimit në rr.”I.Raka”, ndërtimi i kanalizimit në rr.”B.Begunca”, dhe ndërtimi i kanalizimit në oborrin e shkollës fillore “E.Duraku”.

Ndriçimi publik. Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik këtë vit është bërë përmes kopanis kontraktuese për këtë çështje, dhe për këtë arsye nuk kemi pasur probleme. Gjatë gjithë vitin jemi kujdesur për eliminimin e defekteve në ndriçimin publik dhe vlen të përmendet riparimi i ndriçimit për gjate stazës te lumi Nerodime, ka hekurudha, riparimin në Lagje të Re, në rrugën “Skënderbeu”, dhe “Idriz Seferi” Po ashtu, kjo kompani ka bërë edhe dekorimin e qyteti.

Mirëmbajtja verore e rrugëve lokale. Duhet theksuar se gjatë këtij viti në përmasimin e infrastrukture rrugore në rrugët e qytetit, janë mbushur gropat me asfalt me sipërfaqe 45.72 m². Kurrë jemi te mirëmbajtja e rrugëve lokale gjatë sezonit veror, duhet theksuar se; trajtim të veçante ju ka kushtuar rrugës Kaçanik-Gajre –Ivaj, sepse kemi pasur rrëshqitje të pa ndërprera të dheut, duke bërë pastrimin e dheut kësaj rruge. Në pastrimin e dheut kemi intervenuar edhe në rrugën Lamaj-Cakaj-Tifek, dhe “ 2 Korriku”. Jemi kujdesur edhe në rehabilitimin e rrugëve: në fshatin Dubravë, Stagovë, K. i Vjetër, lagjja Fejza, rruga Shtraze-Stanet, në disa lagje të Biqecit, në fshatin Begracë, lagjja Kuqishtë, dhe në lagjen “Mejdi Dalloshi”.

Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale. Për dallim nga vitet tjera, në vitin 2012, kemi pasur reshje mjaft të mëdha të borës. Dhe, duke pasur parasysh gjendje e krijuar të rëndë emergjente nga reshjet e mëdha të borës dhe krijimit të ortekëve nga erërat e forta, ku si pasoj kemi pasur shumë rrugë dhe fshatra të bllokuar në territorin e komunës tonë, më 02.02.2012, ekzekutivi i komunës, në një mbledhje të jashtëzakonshëm, ka deklaruar; Situatë Emergjente në territorin e komunës tonë. Në vendimin që është deklaruar situata emergjente, janë përfshirë edhe disa masa tjera për tejkalimin e kësaj situate:

-Ndërprerja e mësimimit për datën 02 dhe 03 të muajit Shkurt,

-Apel të gjithë qytetarëve për mobilizim të përgjithshëm për ta përballuar këtë situatë, dhe

-Ju është bërë ftesë të gjithë kompanive private që të ndihmojnë në heqjen e borës për zhbllokimin e rrugëve.

Në mbledhjen e mbajtur me datën 03.02.2012, bordi i drejtoreve, pas analizës së bërë të situatës së krijuar nga reshjet e mëdha të borës vendos që mësimi nëpër shkollat e mesme dhe fillore të ndërpritet edhe për datën 06 dhe 07 Shkurt, mirëpo Ministria e Arsimit, merr vendim për ndërprerje e mësimimit në gjithë Kosovën deri më 20 Shkurt.

Kompania kontraktuese për mirëmbajtje dimërore, ka qenë në gjendje gatishmërie 24 orë.

Për shakë të gjendjes së krijuar, jemi detyruar që të hartojmë plane operative për çdo ditë, për hapjen e rrugëve, sipas nevojave dhe kërkesave të qytetarëve, duke ju dhënë prioritet rasteve më të rënda të sëmundjeve.

Prioritet ju kemi dhënë rrugëve, ku kemi pasur persona në dializës, dhe sëmundjeve tjera. Ju kemi përgjigjur edhe KEK-ut, në hapjen e rrugëve nga bora, ku ata kanë pasur nevojë që të intervenojnë për sanimin e defekteve të rrymës.

Prej fillimit të sezonit dimëror e deri në përfundim të sezonit, kompania kontraktuese për heqjen borës ka bërë:

- 1772 orë efektive nëpër rrugët e fshatrave,
- 485 orë efektive nëpër qytetit, dhe

Për tejkalimin e situatës së krijuar nga reshjet e mëdha të borës dhe krijimit të ortekëve nga erërat e mëdha, në mënyrë vullnetare janë paraqitur këto kompani:

- "P&I", pronar Isa Elezi,
- "Kema Commpay", pronar Arsim Kolshi, dhe
- "Fontana" shpk, pronar Bajram Berisha.

Dhe për gatishmërinë që kanë treguar këto kompani për të ndihmuar, komuna merr vendim për stimulimin e tyre me karburante. Ku, gjatë stimulimit të këtyre kompanive janë harxhuar; 1693.46 l naftë.

Nga reshjet e mëdha të datës 11 dhe 12 Shkurtit, u rendua edhe më shumë situata e rrugëve, nga trashësia e madhe e borës, kryetari i komunës 13.02.2012, organizon takim me kompanitë privat, ku edhe një herë kërkon ndihmë prej tyre për të dal nga kjo situatë. Pas këtij takimi, aksionit ju kanë përgjigjur edhe dy kompani:- Shpk" Murseli, pronar Rexhep Murseli dhe - N.N.T "Burimi", pronar Mefail Deda.

Vendet më të rrezikuara dhe që kanë paraqitur vështirësi edhe gjatë intervenimit për shakë të konfiguracionit të terrenit, janë fshatrat: Kerbliq, Dernaglave, Gjurgjedell, Semajë, Sllatinë, Shtrazë dhe Ivajë e Vjetër.

Nga gjendja e krijuar nëpër viset e thella, dhe mundësia e harxhimit të rezervave ushqimore të qytetarëve në këto zona, kryetari i komunës me shumicën e drejtorëve ka vizituar disa zona më të rrezikuara, ku me këtë rast edhe personalisht ka shpërndarë pako ushqimore për banorët e fshatit Kerbilq, dhe Sllatinë. Njëkohësisht, kryetari i komunës gjatë vizitave nëpër shkolla të këtyre zonave, ka dhuruar dy palë këpucë prej mjeteve personale dhe dy palë këpucë prej buxhetit të komunës. Kur jemi te pakot ushqimore duhet theksuar se janë shpërndarë edhe 90 pako tjera të siguruara nga; Kryqi i Kuq Komunal. Shpërndarja e këtyre pakove është bërë nëpër zonat e thella, si: Gjurgjedell, Sllatinë, Semajë e Epërme, Ivaj, Kotlinë, Shtrazë, etj.

Shpërndarja është bërë nga Drejtoria e Shërbime Publike dhe Emergjencës, dhe Kryqi i Kuq i Komunal. Reshjet e mëdha të borës dhe erërat e forta, nuk kanë shkaktuar probleme vetëm në bllokimin e rrugëve, por kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme edhe në dëmtimin e disa shtëpive dhe të disa biznese të vogla dhe të mesme në bujqësi.

• **Shërbimi teknik i mirëmbajtjes së rrugëve, trotuareve, dhe parqeve të qytetit**

Shërbimi teknik i mirëmbajtjes së rrugëve, trotuareve dhe parkut të qytetit, ka kryer punët e për ditshme dhe ato të cilat janë paraqitur sipas nevojës. Është bërë pastrimi i rrugëve, trotuareve dhe mirëmbajtja e parkut të qytetit, dhe dy anët e lumit Nerodime, hapësira e bustit të dëshmorit "Ismail Raka", dhe hapësira bustit "Idriz Seferi" Janë pastruar varrezat e dëshmorëve dhe Pllakat Përkujtimore, çdo herë një ditë para çdo feste dhe sipas nevojës edhe ditëve tjera. Ndërkaq, në pastrimin e qytetit ka ndihmuar edhe projekti "Pastrimi i Përroskave dhe Deponive Ilegal", sipas Memorandumit të Mirëkuptimit, i arritur edhe këtë vit, në mes të Ministrisë së

Punës dhe Mirëqenies Sociale, përmes Zyrës Komunale për Punësim dhe Komunës së Kaçanikut, që ka të bëjë me nxitjen e punësimit përmes projektit të punëve publike. Ky projekt, ka fillua më 01.08.10.2012, janë kyçur 54 punëtor, ku 45 punëtor janë zgjedhur nga Zyra Komunale e Punësimit, në bashkëpunim me organet komunale, dhe 9 tjerë janë zgjedhur nga kompania e cila ka fituar tenderin. Projekti për dallim nga vitet tjera, sipas kërkesës tonë, ka zgjatur 4 muaj, dhe ka përfunduar me 30.11.2012. Gjatë kësaj periudhe, përmes këtij projekti kemi arritur ti pastrojmë këto përrrenj: Lumin Nerodime, dhe pjesën ndër Urën e Konakut, përroin e Rakocit, përroin e 'R.Agushit', përroin e Tushajve, 3 përroit në fshatin Bob, varrezat e qytetit, varrezat e Runjevës, hyrjet e qytetit, zhdukjen e deponive të egra etj. Përveç, punëve të ndryshme, me punëtorët e këtij projekti, kemi intervenuar edhe në shuarjen e zjarreve të hapura fushore, dhe kemi bërë edhe shpërndarjen e druve për familjet skamnor.

► Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari

Drejtoria për Bujqësi Zhvillim Rural dhe Pylltari për periudhën janar-dhjetor 2012, aktivitetin e vet e ka orientuar kryesisht në përmbushjen e objektivave të cilat i ka paraparë në planin e punës për periudhën raportuese.

Drejtoria e bujqësisë ka zhvilluar aktivitetin e vetë në sektorët e saj: sektorin e lavërtarisë, blegtorisë, pemëtarisë dhe në sektorin e pylltarisë, duke u bazuar në kompetencat dhe detyrat e përcaktuara me Statut të Kuvendit të Komunës, ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës

Gjatë kësaj periudhe Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe pylltarisë ka bashkëpunuar me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe me shoqatat (OJQ-ët) vendore.

Bashkëpunimi me MBPZHR ka qenë kryesisht në implementimin e projekteve: projekti për shërbime këshillimore, projektet për subvencionim të fermerëve (projekti për lopë qumështore, kafshëve të imëta, projektit për subvencionimin e mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore) si dhe projektet për mbështetje me grande për sektorët e bujqësisë. Të gjithë fermerëve të cilët kanë qenë të interesuar për aplikim, i është ofruar ndihmë në kompletimin e dokumentacionit të kërkuar për aplikim në subvencionet e ofruara nga MBPZHR dhe përgatitje të projekteve për aplikim për grande, me qëllim që fermerët tanë të përfitojnë sa më shumë.

Nga projektet e MBPZHR: për subvencionim të lopëve qumështore këtë vit kanë përfituar 126 fermerë, në vlerë prej 51.750€, për kafshë të imëta kanë përfituar 24 fermerë në vlerë prej 25.950 € , për bletari kanë përfituar 23 bletar, në shumë prej 8.280 €, nga subvencionet për mbjelljen e misrit kanë përfituar 31 fermerë në vlerë 6.459 €. Sa i përket projekteve për aplikim në grande, kanë përfituar katër fermerë: dy në sektorin e pemëtarisë, njëri për investime në infrastrukturën e pemishteve 9000 € një për mbjelljen e sipërfaqes mepemishte 5.159€ në perimekulturë në projektin e serrave ka përfituar një fermerë në shumë prej 4.991 € dhe në projektet e blegtorisë me grande është mbështetur një fermerë në shumë prej 5.306 €Gjatë këtij viti kemi bashkëpunuar me OJQ-ët vendore HEIFER–Kosova, nga projekti mëshqerrave nga kthimi i pasimeve kanë përfituar 6 fermerë nga një mëshqerrë 12 muajsh, ndarja e tyre është bërë në fshatin Dubravë dhe Doganaj. Nga OJQ Caritas Luxembourg – zyra në Ferizaj kanë përfituar 27 fermerë, në sektorin e bletarisë kanë përfituar 15 bletarë nga 5 koshere bletësh dhe sektorin e perimekulturës 12 fermerë nga një serrë me sipërfaqe prej 144 m². Në bashkëpunim me MBPZHR janë organizuar trajnime për fermerë në sektorin e perimekulturës dhe blegtorisë etj. Gjithashtu kemi bashkëpunuar edhe me OJQ-ën DSF-Kosova përmes Qendrës së Biznesit lidhur me ofrimin e ndihmës në mbështetje të fermerëve dhe subjekteve afariste prodhuese, me linja kreditore me kamata të ulëta 5% me qëllim zhvillimit të bizneseve në komunën tonë. Aplikusve për linja kreditore u kemi ofruar ndihmë në përgatitjen e planit të biznesit dhe kompletimin e dokumentacioneve të kërkuara për aplikim në linjën kreditore.

Nga projekti OJQ-ës DSF-Kosova përmes bashkëpunimit me zyrën e Qendrës për përkrahjen lokale të Bizneseve, nga linja kreditore kanë përfituar fermerët dhe subjektet afariste prodhuese (17) në vlerë prej 107.000 €. Me kërkesë të qytetarëve të adesuara në emër të drejtorisë kemi organizuar aksionin një ditorë për eliminimin e qenve endacak. Në projekt janë përfshirë disa fshatra të komunës dhe qyteti, gjatë zhvillimit të aksionit janë asgjësuar 63 qenë endacak. Kjo drejtori ka qenë e angazhuar edhe në hartimin e projekteve, këtë vit janë realizuar këto projekte:

* Projekti për mbështetje të fermerëve me farë misri dhe pleh mineral, nga ky projekt kanë përfituar 84 fermerë, vlera e projektit **9.640 €**

* Projektin për ngritjen e 10 serrave me sipërfaqe prej 256 m² përfitues 10 fermerë, vlera projektit **36.700 €**, fermerët përfitues kanë participuar 20% të vlerës së projektit

* Projekti për rregullimin e sistemit pikë-pikë të ujitjes në pemëtari, vlera e projektit **8767.50 €** përfitues 25 fermerët të cilët kanë participuar 20% të vlerës së projektit. Me mjetet nga buxheti i komunës (1561€), OJQ-ës DSF-Kosova (750€) dhe Pro Credit Bank (150 €), është realizuar edhe projekti për panairin e gjedhit "Kaçaniku 2012 (12 fermerë kanë përfituar shpërblime në vlerë prej 100-250€), vlera projektit **2.461 €**

Edhe pse me planin e punës kemi paraparë edhe projektet tjera, nuk kemi mundur ti realizojmë në mungesë të buxhetit.

Drejtorija BZHRP ka paraparë investime edhe në lëmin e bletarisë 10.000 €, në lëmin e lavërtarisë, stimulimin e fermerëve për mbjelljen e sipërfaqeve me kulturën e grurit në sipërfaqes prej 0.5-1 ha, të cilët nuk e gëzojnë mbështetjen nga MBPZHR), vlera e projekteve 15.000 €, Projekti për rregullimin e tregut të kafshëve, faza e dytë në vlerë prej 20.000€. Kjo drejtori gjatë vitit raportues ka qenë i angazhuar edhe në projektet të cilat implementohen nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, siç është projekti i shërbimeve këshillimore për fermerë, ku fermerëve vazhdimisht i është ofruar këshilla në aspektin profesional, materiali trajnuar. Sipas kërkesës së Ministrisë Bujqësisë, për planin operativ të mbjelljeve pranverore, vjeshtore si dhe për realizimin e mbjelljeve dhe informata tjera, Ministrisë së Bujqësisë i janë ofruar të dhënat e kërkuara. Gjatë këtij viti nga MBPZHR, prej projekteve për subvencionim: projektit për lopë qumështore, projekti i kafshëve të imëta (deleve dhe dhive), projekti për bletari, nga projektet për grande, projektet e drejtorisë të realizuara nga buxheti i Komunal si dhe nga mbështetja e OJQ-ëve këtë vit kanë përfituar gjithsejtë 372 fermerë të komunës sonë. Gjithashtu gjatë pjesës së dytë të muajit dhjetor kemi filluar me pranimin e aplikacioneve të fermerëve për digjitalizimin e parcelave të mbjella me grurë, që subvencionimi për vitin raportues do të bëhet në pranverë pas verifikimit të ngastrave të mbjella me kulturën e grurit. Numri i fermerëve përfitues nga subvencionet e Ministrisë do të ishte më i madh sikur subvencionimi për mbjelljet vjeshtore (sipërfaqet me mbi 2 ha.) të bëhej në vjeshtë. Me përkrahjen e OJQ-së DSF-Kosova janë organizuar edhe trajnime për hartimin biznes planeve, ku janë trajnuar fermerë prodhues të produkteve bujqësore dhe bizneseve tjera prodhuese jo bujqësore. Gjatë kësaj periudhe është bërë edhe përcjellja e mbjelljeve pranverore, vjeshtore si dhe e fushatës së korrje-shirjeve. Është bërë përcjellja e fushatën e korrje-shirjeve, kontrollimi i kombajnerët rreth cilësisë së korrje-shirjeve, për secilin kombajnerë është mbajtur evidencë për sipërfaqet e korrura me qëllim të raportimit në MBPZHR, lidhur me rendimentin e grurit për ha. dhe shfrytëzimit të subvencioneve të ofruar nga MBPZHR për kombajnerë me çmim më të ulët të derivateve, me qëllim që çmimi i korrjeve të jetë më i favorshëm për fermerë. Janë pranuar 392 kërkesa: 230 në sektorin e pylltarisë për prerje të masës drusore në pyje private, për djegie, 162 në sektorin e bujqësisë të natyrave të ndryshme, prej të cilave 139 kërkesa të parashtruara nga fermerët për mbështetje në kuadër të projekteve të DBZHRP, 19 lëndë për ndërrim destinimi të tokës bujqësore, prej të cilave 11 lëndë janë miratuar dhe ju kanë dërguar aktvendimet për pagesë, 7

prej tyre janë refuzuar, dhe 1 kërkesë është pezulluara për arsye të mos plotësimit me dokumentacionin shtesë të kërkuar. Nga ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë jo bujqësore deri në fundin e muajit dhjetor janë vjelë mjete në shumë prej 2512.50€.

Në kuadër të projekteve të drejtorisë BZHRP, prej 139 fermerëve që kanë aplikuar, 119 prej tyre kanë përfituar. Vlen të theksohet se fermerët përfitues janë zgjedhur, pas monitorimit të fermerëve nga komisioni komunal.

Përveç organizimit të trajnimeve, seminareve të ndryshëm me fermerë kjo drejtori ka qenë e hapur për dhënie të këshillave profesionale për të gjithë fermerët të cilët kanë kërkuar një ndihmë të tillë, qoftë edhe ata individual.

Sektori i veterinarisë

Edhe pse është i nevojshëm inspektori i veterinarisë këtu ende kemi një vakum rreth këtij sektori, megjithatë është në kompetencë e AVUK-ut për plotësimin e këtij vakumi. Pasi që shërbimi veterinar me gjithë kompetencat e veta sipas Ligjit për veterinarinë ka kaluar në AVUK (Agjensioni i Veterinarisë dhe Ushqimit të Kosovës).

Sektori i pylltarisë

Për këtë sektor mund të ofrojmë të dhëna lidhur me organizimin e sektorit të pylltarisë. Sa i përket këtij sektori nuk ka vend për kënaqësi edhe përkundër angazhimeve tona për mbrojtjen e pyjeve nga prerësit ilegal, dëme kemi në disa rajone më shumë e në disa më pakë, nuk kemi arritur të ndalojmë plotësisht prerjet ilegale edhe përkundër vullnetit dhe dëshirës për të penguar këtë dukuri negative që është prezent në çdo komunë. Për pengimin e kësaj dukurie, drejtori i drejtorisë bashkë me stafin e sektorit të pylltarisë në bashkëpunim me policinë kanë shtuar masat e veprimit për mbrojtjen e pyjeve nga prerësit ilegal.

Për pengimin e kësaj dukurie negative janë bërë asistime të shpeshta gjatë ditës dhe natës nga Policia e Kosovës, në shoqërim të rojeve të pyllit dhe stafit të sektorit të pylltarisë. Gjatë këtij viti në kuadër të drejtorisë në sektorin e pylltarisë janë zhvilluar aktivitete në shfrytëzimin e pyjeve siç vijon:

Gjatë vitit 2012 në Njësinë “Uji i Bardh” vendi i quajtur “Ordenicë”, në afërsi të fshatit Biçec janë pyllëzuar 30 ha me (91.000 fidanë) të llojit të pishës së bardhë dhe hermoqit.

Në njësinë “Ahishta” është bërë shpallja e Ankandit Publik për ngastrat nr. 2, 3, 7,9 dhe 10 për prerjen e masës drusore prej 4252.08 m³, prej tyre dru teknik 1382.87 m³ dhe 2869.21 m³ dru zjarri. Gjatë Ankandit publikë kanë ofertuar 4 operatorë ekonomik. Dy operatorë ekonomik ka qenë përfitues i shfrytëzimit të kësaj mase drusore, të cilët kanë filluar të operojnë në ngastrat e lartë cekura. Operatorët ekonomik gjatë periudhës prill - 20 dhjetor kanë arritur të shfrytëzojnë 80 % të masës drusore të kontraktuar. Prej masës së përgjithshme drusore 4252.08 m³ janë realizuar 954.70 m³ dru teknik dhe 1269 m³ dru zjarri. Sasia e masës drusore e realizuar për vitin 2012 ka përfunduar më 20 dhjetor, për shkak të skadimit të kontratës mirëpo në ngastrat 2,3,7,9 dhe 10 punët nuk janë përfunduar në prerje, zhagitje dhe transport andaj ende ka sasi të masës drusore të prera dhe të pa prera nga operatori ekonomik në pa mundësi të kryerjes së punëve për arsye të konfiguracionit të terrenit të pa përshtatshëm për bartje. Nga shitja e masës drusore të kontraktuar përmes Ankandit publik janë realizuar mjete financiare në shumë prej 53.831.28€ të cilat janë derdhur në llogarinë e Buxhetit të konsoliduar të Kosovës, prej kësaj shume në llogarinë e buxhetit të Komunës janë derdhur 9.493,24 €. Vlen të theksohet se në muajin dhjetor ka filluar edhe regjistrimi i dëmit nga prerjet ilegale në njësitë ekonomike “Ahishta”, “Uji i Bardhë” dhe “Bodoshnjak” për arsye të kushteve atmosferike dhe në mungesë të stafit regjistrimi është ndërprerë përkohësisht deri në rregullimin e kohës. Në këtë vit në kuadër të drejtorisë janë konfiskuar 227.16 m³ apo shprehur në metër hapësinor 324.84 . Numri i fletëparaqitjeve të dërguara në Gjykata-

Prokurori për periudhën raportuese është 521(fletëparaqitje për kundërvajtje 461transport ilegal dhe 58 vepër penale). Llogaritur në vlerën përgjithshme të dëmit të shkaktuar nga prerjet ilegale kapë shumën në vlerë prej 79.471.80 €. Sa i përket pyjeve private në bazë të kërkesave të parashtruara (196), të gjitha kërkesat janë shqyrtuar në bashkëpunim me zyrtarë e APK-ës të zyrës regjionale Ferizaj. Prej kërkesave të parashtruara 162 kërkesa janë kryer në tërësi, 34 kërkesa tjera të parashtruara nga qytetarët është kryer vetëm damkosja në rrënjë . Në mungesë të interesimit të palëve masa drusore ka mbetur e pa vulosur dhe e pa shfrytëzuar. Është bërë shënjimi i masës drusore, sasia e masës drusore të shënjuar në ballë në të gjitha lokalitetet është 3.921.35 m³. Në pyjet private janë bërë 162 vështrime profesionale.

Fletë dërgesa të dhëna 847.

Të hyrat nga taksat në shërbime për pyje private janë 6664.76€.

Të hyrat nga pagesa për mbeturina kapë shumën 1490 €.

Të hyrat nga shpallja e Ankandit publik për prerje të masës drusore 220 €

Të hyrat nga pëlqimet për shfrytëzimin e pronës shoqërore dhe komunale 200 €



► **Sektori i Emergjencës (Mbrojtja dhe Shpëtimi)**

Intervenimet e SHZSH sipas llojit , gjatë muajve të vitit 2012

Lloji i intervenimit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej
Objekte ndërtimore shtëpi,banesa,lokale	1	4	4	3	1	2	2	1	2	3	2	2	27
Zjarre te hapura ,fusha, male ,mbeturina	1		48	11	5	5	41	71	39	12		1	234
Zjarre ne automjete				1		1	1	2			2	1	8
Shtyllë elektrike, trafo,etj			1		1							1	3
Ushqim i kafshëve				1									1
Intervenime teknike	1	1	1			1	1	1		1			7
Shërbime		1		1	1		1	2			1		7
Aksidente rrugore	1		1			1	2					1	6
Ndihme gjate dhe pas vërshimeve		1		1									2
Objekte ndihmëse (Shupa, stalla)							3						3
Gjithsej	4	7	55	18	8	10	51	77	41	16	5	6	298

Paraqitja grafike e zjarreve të hapura 2006-2012 (male, fusha dhe mbeturina)

Viti	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Rastet	10	93	79	15	45	170	234



Viti	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2011	3	6	15	22	2	13	17	50	70	5	26	9
2012	4	7	55	18	8	10	51	77	41	16	5	6

Shërbimi i Zjarrfikës dhe Shpëtimit në Kaçanik në vitin që lamë pas kishte intervenime gjegjësisht shërbime rekorde në krahasim me vitet e pasluftës që nga krijimi i Shërbimit. Madje, edhe më tepër se viti rekord 2011, që ishte një vit për tu mbajtur mend. Më poshtë prezantojmë tabelën numerike të intervenimeve sipas llojit të intervenimit,

Intervenimet në përgjithësi të Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit

Objekte ndërtimore ,shtëpi, banesa. lokale	27
Zjarre te hapura, fusha,male,mbeturina	234
Zjarre ne automjete	8
Shtylla elektrike-etj	3
Ushqim i kafshëve	1
Intervenime teknike	7
Shërbime	7
Aksidente rrugore	6
Ndihme gjate dhe pas vërshimeve	2
Objekte ndihmese, stalla, shupa etj	3
Gjithsej	298

Karakteristikë e këtij viti ishte numri më i rritur i zjarreve të ashtuquajtura të hapura, (fusha ,male dhe mbeturina) gjithsejtë 234 intervenime , që rritë dukshëm numrin e përgjithshëm të intervenimeve në 298 gjatë vitit 2012, që arrin një rekord të palakueshëm që nga formimi i Shërbimit Zjarrfikës në Kaçanik, nga paslufta e këtej. Nga numri i përgjithshëm i zjarreve të tipit të hapur, intervenime në zjarre të mbeturinave të ndryshme ishin 44 raste , në fusha (ku ishin kryesisht sërrishta dhe bari i thatë) 88 raste me 163 hektar dhe zjarre në male 102 raste me 313.83 hektar.

Në krahasim me vitin 2011 numri i intervenimeve në përgjithësi është rritur për 25 % e që është për tu shqetësuar duke marrë parasysh numrin e vogël të stafit dhe teknikën zjarrfikëse jo adekuat për intervenime e sidomos në zjarret fushore-malore.

Për përballimin e kësaj situatë është dashur angazhim shtesë i tërë stafit të SHZSH, e sidomos në muajt Mars, Korrik, Gusht dhe Shtator kur zjarret fushore malore janë më të theksuara. Në disa raste janë angazhuar punëtorët sezonal që ishin të angazhuar nga DESHP për pastrim të qytetit .

Krahasimet ndër muaj na qojnë në konkludim se gjatë muajit Gusht pati me së shumti intervenime gjithsejtë 77, ku prej tyre 71 të tipit fushore-malor kur në masë të madhe është bërë djegia e qëllimshme e hamulloreve (sërrishtave) para lëvrimit të arave për mbjellje.

Në muajin Mars dhe Shtator patëm më së shumti ndezje të maleve të ultë pasi që vegetacioni ishte i tharë, ku në të shumtën e rasteve me qëllim të hapjes së kullosave, zjarret janë shkaktuar nga barinj të qëllimisht. Vështirësi në vete ishte pamundësia e arritjes me teknikë zjarrfikëse në vendin e ngjarjes e sidomos në fushat gjegjësisht kullosat e Golines, në malet e Sharrit gjegjësisht në Luboten,dhe në zjarret e pyjeve në vendin e quajtur “Bilak –Llokme” ne Kurbali ku terrenet ishin shumë të vështira .

Ky fakt në përgjithësi e ka rritur kohën e arritjes në vend të ngjarjes nga momenti i marrjes së informatës mbi incidentin e deri te arritja në vendin e incidentit, që mesatarisht për të gjitha intervenimet është 20 minuta, e që nuk duhej të ishte mbi 10 minuta. Kjo tregon një mos mbulim adekuat të terrenit sipas standardeve evropiane nga ana e shërbimeve emergjente, që intervenimet të ishin më cilësorë dhe më me kohë.

Me qëllim të parandalimit me kohë dhe mospërhapja e shpejtë e zjarreve në fusha e male janë bërë patrullime me automjetin e terrenit Toyota gjatë muajve të nxehtë, ku me një ekip lëvizës janë shuar shumë zjarre menjëherë që në fillim të tyre. Kjo ka ndikuar që në asnjë rast zjarret të mos kalojnë nga fushat e hapura në objektet banesore apo objektet tjera ndihmëse familjare, edhe pse disa here shume lagje kanë qenë të kërcënuara nga një mundësi e tillë, si në Kaçanik të Vjetër, Doganaj, Gërllicë e Epërme, Elezaj dhe disa raste tjera me të vogla.

Edhe përkundër hapjes së Shërbimit zjarrfikës në Hanë të Elezit edhe më tutje nga SHZSH në Kaçanik, kërkohet ndihmë në intervenime në këtë teren pasi që atje nuk është vendosur kujdestaria e përhershme.

► Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari

Drejtoria për Bujqësi Zhvillim Rural dhe Pylltari për periudhën janar-dhjetor 2012, aktivitetin e vet e ka orientuar kryesisht në përmbushjen e objektivave të cilat i ka paraparë në planin e punës për periudhën raportuese.

Drejtoria e bujqësisë ka zhvilluar aktivitetin e vetë në sektorët e saj: sektorin e lavërtarisë, blegtorisë, pemëtarisë dhe në sektorin e pylltarisë, duke u bazuar në kompetencat dhe detyrat e përcaktuara me Statut të Kuvendit të Komunës, ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës

Gjatë kësaj periudhe Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe pylltarisë ka bashkëpunuar me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe me shoqatat (OJQ-ët) vendore.

Bashkëpunimi me MBPZHR ka qenë kryesisht në implementimin e projekteve: projekti për shërbime këshillimore, projektet për subvencionim të fermerëve (projekti për lopë qumështore, kafshëve të imëta, projektin për subvencionimin e mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore) si dhe projektet për mbështetje me grande për sektorët e bujqësisë. Të gjithë fermerëve të cilët kanë qenë të interesuar për aplikim, i është ofruar ndihmë në kompletimin e dokumentacionit të kërkuar për aplikim në subvencionet e ofruara nga MBPZHR dhe përgatitje të projekteve për aplikim për grande, me qëllim që fermerët tanë të përfitojnë sa më shumë.

Nga projektet e MBPZHR: për subvencionim të lopëve qumështore këtë vit kanë përfituar 126 fermerë, në vlerë prej 51.750€, për kafshë të imëta kanë përfituar 24 fermerë në vlerë prej 25.950 €, për bletari kanë përfituar 23 bletar, në shumë prej 8.280 €, nga subvencionet për mbjelljen e misrit kanë përfituar 31 fermerë në vlerë 6.459 €. Sa i përket projekteve për aplikim në grande, kanë përfituar katër fermerë: dy në sektorin e pemëtarisë, njëri për investime në infrastrukturën e pemishteve 9000 € një për mbjelljen e sipërfaqes me pemishte 5.159€ në perimekulturë në projektin e serrave ka përfituar një fermerë në shumë prej 4.991 € dhe në projektet e blegtorisë me grande është mbështetur një fermerë në shumë prej 5.306 € Gjatë këtij viti kemi bashkëpunuar me OJQ-ët vendore HEIFER–Kosova, nga projekti mëshqerrave nga kthimi i pasimeve kanë përfituar 6 fermerë nga një mëshqerrë 12 muajsh, ndarja e tyre është bërë në fshatin Dubravë dhe Doganaj. Nga OJQ Caritas Luxembourg –

zyra në Ferizaj kanë përfituar 27 fermerë, në sektorin e bletarisë kanë përfituar 15 bletarë nga 5 koshere bletësh dhe sektorin e perimekulturës 12 fermerë nga një serrë me sipërfaqe prej 144 m². Në bashkëpunim me MBPZHR janë organizuar trajnime për fermerë në sektorin e perimekulturës dhe blegtorisë etj. Gjithashtu kemi bashkëpunuar edhe me OJQ-ën DSF-Kosova përmes Qendrës së Biznesit lidhur me ofrimin e ndihmës në mbështetje të fermerëve dhe subjekteve afariste prodhuese, me linja kreditore me kamata të ulëta 5% me qëllim zhvillimit të bizneseve në komunën tonë. Aplikusve për linja kreditore u kemi ofruar ndihmë në përgatitjen e planit të biznesit dhe kompletimin e dokumentacioneve të kërkuara për aplikim në linjën kreditore. Nga projekti OJQ-ës DSF-Kosova përmes bashkëpunimit me zyrën e Qendrës për përkrahjen lokale të Bizneseve, nga linja kreditore kanë përfituar fermerët dhe subjektet afariste prodhuese (17) në vlerë prej 107.000 €. Me kërkesë të qytetarëve të adresuara në emër të drejtorisë kemi organizuar aksionin një ditorë për eliminimin e qenve endacak. Në projekt janë përfshirë disa fshatra të komunës dhe qyteti, gjatë zhvillimit të aksionit janë asgjësuar 63 qenë endacak. Kjo drejtori ka qenë e angazhuar edhe në hartimin e projekteve, këtë vit janë realizuar këto projekte:

* Projekti për mbështetje të fermerëve me farë misri dhe pleh mineral, nga ky projekt kanë përfituar 84 fermerë, vlera e projektit **9.640 €**

* Projektin për ngritjen e 10 serrave me sipërfaqe prej 256 m² përfitues 10 fermerë, vlera projektit **36.700 €**, fermerët përfitues kanë participuar 20% të vlerës së projektit

* Projekti për rregullimin e sistemit pikë-pikë të ujitjes në pemëtari, vlera e projektit **8767.50 €** përfitues 25 fermerët të cilët kanë participuar 20% të vlerës së projektit. Me mjetet nga buxheti i komunës (1561€), OJQ-ës DSF-Kosova (750€) dhe Pro Credit Bank (150 €), është realizuar edhe projekti për panairin e gjedhit "Kaçaniku 2012 (12 fermerë kanë përfituar shpërblime në vlerë prej 100-250€), vlera projektit **2.461 €**

Edhe pse me planin e punës kemi paraparë edhe projektet tjera, nuk kemi mundur ti realizojmë në mungesë të buxhetit.

Drejtorija BZHRP ka paraparë investime edhe në lëmin e bletarisë 10.000 €, në lëmin e lavërtarisë, stimulimin e fermerëve për mbjelljen e sipërfaqeve me kulturën e grurit në sipërfaqes prej 0.5-1 ha, të cilët nuk e gëzojnë mbështetjen nga MBPZHR), vlera e projekteve 15.000 €, Projekti për rregullimin e regut të kafshëve, faza e dytë në vlerë prej 20.000€. Kjo drejtori gjatë vitit raportues ka qerë i angazhuar edhe në projektet të cilat implementohen nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, siç është projekti i shërbimeve këshillimore për fermerë, ku fermerëve vazhdimisht i është ofruar këshilla në aspektin profesional, materiali trajnuet. Sipas kërkesës së Ministrisë Bujqësisë, për planin operativ të mbjelljeve pranverore, vjeshtore si dhe për realizimin e mbjelljeve dhe informata tjera, Ministrisë së Bujqësisë i janë ofruar të dhënat e kërkuara. Gjatë këtij viti nga MBPZHR, prej projekteve për subvencionim: projektit për lopë qumështore, projekti i kafshëve të imëta (deleve dhe dhive), projekti për bletari, nga projektet për grande, projektet e drejtorisë të realizuara nga buxheti i Komunal si dhe nga mbështetja e OJQ-ëve këtë vit kanë përfituar gjithsejtë 372 fermerë të komunës sonë. Gjithashtu gjatë pjesës së dytë të muajit dhjetor kemi filluar me pranimin e aplikacioneve të fermerëve për digjitalizimin e parcelave të mbjella me grurë, që subvencionimi për vitin raportues do të bëhet në pranverë pas verifikimit të ngastrave të mbjella me kulturën e grurit. Numri i fermerëve përfitues nga subvencionet e Ministrisë do të ishte më i madh sikur subvencionimi për mbjelljet vjeshtore (sipërfaqet me mbi 2 ha.) të bëhej në vjeshtë. Me përkrahjen e OJQ-së DSF-Kosova janë organizuar edhe trajnime për hartimin biznes planeve, ku janë trajnuar fermerë prodhues të

produkteve bujqësore dhe bizneseve tjera prodhuese jo bujqësore. Gjatë kësaj periudhe është bërë edhe përcjellja e mbjelljeve pranverore, vjeshtore si dhe e fushatës së korrje-shirjeve. Është bërë përcjellja e fushatën e korrje-shirjeve, kontrollimi i kombajnerët rreth cilësisë së korrje-shirjeve, për secilin kombajnerë është mbajtur evidencë për sipërfaqet e korrura me qëllim të raportimit në MBPZHR, lidhur me rendimentin e grurit për ha. dhe shfrytëzimit të subvencioneve të ofruar nga MBPZHR për kombajnerë me çmim më të ulët të derivateve, me qëllim që çmimi i korrjeve të jetë më i favorshëm për fermerë. Janë pranuar 392 kërkesa: 230 në sektorin e pylltarisë për prerje të masës drusore në pyje private, për djegie, 162 në sektorin e bujqësisë të natyrave të ndryshme, prej të cilave 139 kërkesa të parashtruara nga fermerët për mbështetje në kuadër të projekteve të DBZHRP, 19 lëndë për ndërrim destinimi të tokës bujqësore, prej të cilave 11 lëndë janë miratuar dhe ju kanë dërguar aktvendimet për pagesë, 7 prej tyre janë refuzuar, dhe 1 kërkesë është pezulluar për arsye të mos plotësimin me dokumentacionin shtesë të kërkuar. Nga ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë jo bujqësore deri në fundin e muajit dhjetor janë vjelë mjete në shumë prej 2512.50€.

Në kuadër të projekteve të drejtorisë BZHRP, prej 139 fermerëve që kanë aplikuar, 119 prej tyre kanë përfituar. Vlen të theksohet se fermerët përfitues janë zgjedhur, pas monitorimit të fermerëve nga komisioni komunal.

Përveç organizimit të trajnimeve, seminareve të ndryshëm me fermerë kjo drejtori ka qenë e hapur për dhënien e këshillave profesionale për të gjithë fermerët të cilët kanë kërkuar një ndihmë të tillë, qoftë edhe ata individual.

Spektori i veterinarisë

Edhe pse është i nevojshëm inspektori i veterinarisë këtu ende kemi një vakum rreth këtij sektori, megjithatë është në kompetencë e AVUK-ut për plotësimin e këtij vakumi. Pasi që shërbimi veterinar me gjithë kompetencat e veta sipas Ligjit për veterinarinë ka kaluar në AVUK (Agjensioni i Veterinarisë dhe Ushqimit të Kosovës).

Spektori i pylltarisë

Për këtë sektor mundë të ofrojmë të dhëna lidhur me organizimin e sektorit të pylltarisë. Sa i përket këtij sektori nuk ka vend për kënaqësi edhe përkundër angazhimeve tona për mbrojtjen e pyjeve nga prerësit ilegal, dëme kemi në disa rajone më shumë e në disa më pakë, nuk kemi arritur të ndalojmë plotësisht prerjet ilegale edhe përkundër vullnetit dhe dëshirës për të penguar këtë dukuri negative që është prezent në çdo komunë. Për pengimin e kësaj dukurie, drejtori i drejtorisë bashkë me stafin e sektorit të pylltarisë në bashkëpunim me policinë kanë shtuar masat e veprimit për mbrojtjen e pyjeve nga prerësit ilegal. Për pengimin e kësaj dukurie negative janë bërë asistime të shpeshta gjatë ditës dhe natës nga Policia e Kosovës, në shoqërim të rojeve të pyllit dhe stafit të sektorit të pylltarisë. Gjatë këtij viti në kuadër të drejtorisë në sektorin e pylltarisë janë zhvilluar aktivitete në shfrytëzimin e pyjeve siç vijon:

Gjatë vitit 2012 në Njësinë “Uji i Bardh” vendi i quajtur “Ordenicë”, në afërsi të fshatit Biçec janë pyllëzuar 30 ha me (91.000 fidanë) të llojit të pishës së bardhë dhe hermoqit. Në njësinë “Ahishta” është bërë shpallja e Ankandit Publik për ngastrat nr. 2, 3, 7,9 dhe 10 për prerjen e masës drusore prej 4252.08 m³, prej tyre dru teknik 1382.87 m³ dhe 2869.21 m³ dru zjarri. Gjatë Ankandit publikë kanë ofertuar 4 operatorë ekonomik. Dy operatorë ekonomik ka qenë përfitues i shfrytëzimit të kësaj mase drusore, të cilët kanë filluar të operojnë në ngastrat e lartë cekura. Operatorët ekonomik gjatë periudhës prill - 20 dhjetor kanë arritur të shfrytëzojnë 80 % të masës drusore të kontraktuar. Prej masës së përgjithshme

drusore 4252.08 m³ janë realizuar 954.70 m³ dru teknik dhe 1269 m³ dru zjarri. Sasia e masës drusore e realizuar për vitin 2012 ka përfunduar më 20 dhjetor, për shkak të skadimit të kontratës mirëpo në ngastrat 2,3,7,9 dhe 10 punët nuk janë përfunduar në prerje, zhagitje dhe transport andaj ende ka sasi të masës drusore të prera dhe të pa prera nga operatori ekonomik në pa mundësi të kryerjes së punëve për arsye të konfiguracionit të terrenit të pa përshtatshëm për bartje. Nga shitja e masës drusore të kontraktuar përmes Ankandit publik janë realizuar mjete financiare në shumë prej 53.831.28€ të cilat janë derdhur në llogarinë e Buxhetit të konsoliduar të Kosovës, prej kësaj shume në llogarinë e buxhetit të Komunës janë derdhur 9.493,24 €. Vlen të theksohet se në muajindhjetor ka filluar edhe regjistrimi i dëmit nga prerjet ilegale në njësitë ekonomike “Ahishta”, ”Uji i Bardhë” dhe “Bodoshnjak” për arsye të kushteve atmosferike dhe në mungesë të stafit regjistrimi është ndërprerë përkohësisht deri në rregullimin e kohës. Në këtë vit në kuadër të drejtorisë janë konfiskuar 227.16 m³ apo shprehur në metër hapësinor 324.84 . Numri i fletëparaqitjeve të dërguara në Gjykata-Prokurori për periudhën raportuese është 521(fletëparaqitje për kundërvajtje 461transport ilegal dhe 58 vepër penale). Llogaritur në vlerën përgjithshme të dëmit të shkaktuar nga prerjet ilegale kapë shumën në vlerë prej 79.471.80 €. Sa i përket pyjeve private në bazë të kërkesave të parashtruara (196), të gjitha kërkesat janë shqyrtuar në bashkëpunim me zyrtarë e APK-ës të zyrës regjionale Ferizaj. Prej kërkesave të parashtruara 162 kërkesa janë kryer në tërësi, 34 kërkesa tjera të parashtruara nga qytetarët është kryer vetëm damkosja në rrënjë . Në mungesë të interesimit të palëve masa drusore ka mbetur e pa vulosur dhe e pa shfrytëzuar. Është bërë shënjimi i masës drusore, sasia e masës drusore të shënuar në ballë në të gjitha lokalitetet është 3.921.35 m³. Në pyjet private janë bërë 162 vështrime profesionale.

Fletë dërgesa të dhëna 847.

Të hyrat nga taksat në shërbime për pyje private janë 6664.76€.

Të hyrat nga pagesa për mbeturina kapë shumën 1490 €.

Të hyrat nga shpallja e Ankandit publik për prerje të masës drusore 220 €

Të hyrat nga pëlqimet për shfrytëzimin e pronës shoqërore dhe komunale 200 €